

Vendim nr. 69 datë 27.12.2023

(V-69/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Blerina Basha, në datën 19.12.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 9 (Gj) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUESE: GJYKATA E LARTË,
GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Mimoza Arbi dhe Artur Baku, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Besmir Beja dhe Irma Qosja, me autorizim.

DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me autorizim.

AVOKATI I POPULLIT, Erinda Ballanca, e paraqitur personalisht në gjykim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 377 të Kodit Civil, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (*gjykatat referuese*), të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë (*Kuvendi*), Këshillit të Ministrave, Dhomës Kombëtare të Noterisë, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Avokatit të Popullit, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datat 01.06.2023 dhe 26.07.2023, gjykatat referuese, Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 377 të Kodit Civil (*KC*). Kjo dispozitë parashikon: *“Trashëgimlënësi që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vet, në favor të çdo personi fizik apo juridik.”*

2. Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga trashëgimtarja e vetme ligjore e trashëgimlënëses. Kjo e fundit ka disponuar pasurinë e saj (apartament i ndodhur në lagjen “Rilindja”, Vlorë) me testamentin e datës 04.10.1993, duke caktuar si trashëgimtar të vetëm nipin e bashkëshortit. Pas vdekjes së trashëgimlënëses, në datën 24.10.1996, noteri ka përpiluar procesverbal në datën 07.03.2007, me të cilin ka konfirmuar ekzistencën e testamentit dhe me kërkesën e trashëgimtarit (përfituesit me testament), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin e datës 30.03.2007 ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë. Pas lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë, ky shtetas ka poseduar pasurinë apartament, në të cilën ka jetuar në mënyrë të pandërprerë për një periudhë 16-vjeçare. Trashëgimtarja ligjore, bazuar në nenin 349 e vijues të KC-së, i është drejtuar gjykatës me padi kundërdrejtuar trashëgimtarit testamentar, për njohjen e saj pronare për këtë pasuri, me pretendimin se testamenti është absolutisht i pavlefshëm, pasi është kryer në kundërshtim me ligjin e kohës, nenet 104, 105, 106 e 112 të KC-së të vitit 1982, sepse nipi i bashkëshortit nuk përfshihet në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë. Po kështu, edhe ky i fundit ka paraqitur kundërpadi, bazuar në nenin 168 të KC-së, me objekt detyrimin e paditëses së kundërpaditur që ta njohë pronar të vetëm për pasurinë e paluajtshme apartament, duke pretenduar se plotësohen kushtet ligjore të fitimit të pronësisë me parashkrim fitues.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 285, datë 05.02.2008, ka vendosur të pranojë padinë, duke detyruar të paditurin kundërpaditës të njohë si trashëgimtare ligjore paditësen dhe t'i dorëzojë asaj pasurinë e paluajtshme, si dhe ka rrëzuar kundërpadinë. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 402, datë 22.10.2009, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket rrëzimit të kundërpadisë, dhe e ka ndryshuar atë për pjesën tjetër, duke vendosur edhe rrëzimin e padisë. Ky vendim është prishur me vendimin nr. 00-2014-865 (115), datë 03.04.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 83, datë 09.07.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 285, datë 05.02.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë, për rrjedhojë detyrimin e palës paditëse të kundërpaditur të njohë palën e paditur kundërpaditëse pronar me parashkrim fitues për pasurinë e paluajtshme objekt gjykimi. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë paditësja e kundërpaditur.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, fillimisht, ka vendosur shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit dhe më pas e ka kaluar atë në seancë gjyqësore. Në seancën gjyqësore të datës 22.02.2023, Kolegji Civil, pasi ka vënë në diskutim çështjen e kushtetutshmërisë së nenit 377 të KC-së, ka vendosur shtyrjen e saj për t'u dhënë mundësinë palëve që të paraqesin argumentet e tyre në këtë drejtim. Në seancën gjyqësore të datës 06.03.2023, Kolegji Civil, pasi ka dëgjuar palët ndërgjyqëse, ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe ka vendosur pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve në Gjykatë për shfuqizimin e nenit 377 të KC-së, si të papajtueshëm me Kushtetutën, pasi bie në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës.

5. Për sa i përket çështjes së paraqitur nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, me testamentin e datës 02.12.2017, trashëgimlënësi ka disponuar pasurinë e tij, duke përcaktuar si trashëgimtarë testamentarë bashkëjetuesen dhe djalin e tij të mitur. Ish-bashkëshortja e trashëgimlënësit, si përfaqësuese e djalit të tyre të mitur, ka paraqitur padi me objekt pavlefshmërinë absolute të testamentit për pjesën që ka disponuar për bashkëjetuesen dhe njohjen si trashëgimtar të vetëm të djalit të saj të mitur. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2085, datë 17.12.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj e në prova. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim ish- bashkëshortja e trashëgimlënësit.

6. Gjykata e Apelit Vlorë, pasi ka shqyrtuar çështjen në seancën gjyqësore të datës 28.06.2022 dhe ka dëgjuar palët ndërgjyqëse, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatë për të vlerësuar pajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 377 të KC-së.

7. Kolegji i Gjykatës, me vendimet e datës 11.09.2023 ka vendosur kalimin e të dyja kërkesave për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimet e datës 20.09.2023, ka vendosur: (i) bashkimin e tyre në një të vetme; (ii) dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

8. Me vendimin nr. 505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm janë riorganizuar për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, me seli në Tiranë, e cila ka filluar funksionimin në datën 01.02.2023. Për rrjedhojë, në tekstin e këtij vendimi Gjykata do t’i referohet Gjykatës së Apelit Vlorë me emërtimin “Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. *Gjykata referuese, Gjykata e Lartë*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

9.1. *Për legjitimitimin:*

9.1.1. Në rastin konkret, plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e legjitimitimit. Gjykata referuese ka përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes, konkretisht nenin 377 të KC-së, i cili përcakton dhe rregullon në mënyrë specifike caktimin e trashëgimitarit testamentar, duke ndaluar disponimin me testament të pasurisë në favor të një personi të tretë, për aq kohë sa trashëgimlënësi ka lënë trashëgimtarë ligjorë të përcaktuar nga kjo dispozitë. Ajo ka krijuar edhe bindjen se gjykimi nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatë. Gjithashtu, është e pamundur të bëhet një interpretim pajtues i normës me Kushtetutën, pasi neni 377 i KC-së është kategorik në rregullimin e tij si një dispozitë e mbyllur që nuk lë asnjë shteg për interpretim të zgjeruar dhe, si e tillë, kjo dispozitë është interpretuar kështu, në mënyrë vazhduese nga gjykatat që nga viti 1994. Për

rrjedhojë, ajo ka argumentuar se është e pamundur t'i japë kuptim të ndryshëm pa cenuar parimet e ndarjes së pushteteve, sigurisë juridike dhe atij të barazisë para ligjit.

9.2. *Për themelin:*

9.2.1. Dispozita e kundërshtuar cenon *të drejtën e pronës private*, e sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës. Referuar kësaj norme, si dhe përmbajtjes së dispozitave të KC-së (*nenet 296, 302 dhe 304*), posedimi, gëzimi dhe disponimi janë tre tagrat kryesore të pronarit, ku një nga mënyrat e disponimit është nëpërmjet trashëgimisë, qoftë ajo me ligj ose me testament. Në rastin e trashëgimisë testamentare, trashëgimlënësi, me vullnetin e tij të lirë, disponon me një akt të njëanshëm testamentin, të gjithë ose një pjesë të pasurisë, të një ose disa trashëgimtarë, ose përjashton nga shtrirja e të drejtave trashëgimore një apo disa trashëgimtarë. Në kuptim të nenit 372 të KC-së, në parim, testatori është i lirë të disponojë pasurinë e tij pas vdekjes, sipas gjykimit dhe vullnetit të tij të lirë, ndërsa neni 377 i KC-së e kufizon lirinë e disponimit të pronës.

9.2.1.1. Kufizimi i së drejtës së pronës private është bërë në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Edhe pse kriteri i kufizimit me ligj është respektuar, në rastin konkret *nuk respektohet kriteri i interesit publik*, për shkak edhe të zgjedhjeve të mëvonshme të ligjvënësit. Referuar nenit 201 të Kodit të Familjes (KF), detyrimi për ushqim nuk është kategorik dhe lidhet me përmbushjen e disa kriterëve të caktuara. Nëse këto kriterë nuk plotësohen, atëherë edhe detyrimi për ushqim nuk justifikohet ligjërisht. Referuar radhëve konkrete të detyrimit për ushqim që barazohen e përkojnë edhe me radhët e trashëgimisë, sipas nenit 197 të KF-së, për fëmijët që janë në radhën e parë të trashëgimisë, detyrimi ligjor për t'u kujdesur për ta përfundon sipas rastit, deri kur arrijnë moshën madhore (18 vjeç) ose deri në moshën 25 vjeç. Për rrjedhojë, nuk ka asnjë interes publik që trashëgimia të kalojë te fëmijët që janë mbi këtë moshë, përderisa prindi nuk ka më asnjë detyrim ligjor. Ndërkohë që fëmijët e mitur në trashëgimi mbrohen edhe nga ana e parashikimeve të rezervës ligjore që është një tjetër kufizim që rrjedh nga KC-ja. Edhe neni 199 i KF-së e lidh detyrimin ndërmjet bashkëshortëve me paaftësinë për punë dhe mjete të mjaftueshme për të jetuar, pra nuk është kategorik. Pavarësisht kësaj, ndodhet ose jo në këto kushte, neni 377 i KF-së

është kategorik përderisa bashkëshorti pasjetues është, sipas rastit, pjesë e radhës së parë, të dytë ose të tretë të trashëgimisë. Madje ky detyrim kufizohet nga neni 200 i KF-së. Për sa u përket vëllezërve dhe motrave, të cilët janë pjesë e radhës së tretë të trashëgimisë, sipas nenit 203 të KF-së, një person në gjallërinë e tij detyrohet ndaj vëllezërve dhe motrave vetëm në kushte të caktuara, kurse në rast disponimi me testament, ka kufizime kategorike për disponimin e pasurisë, megjithëse vëllezërit dhe motrat mund të mos jenë në kushtet e nevojës. Pra, qartazi, rregullimet e nenit 377 të KC-së nuk mbartin asnjë interes publik.

9.2.1.2. *Nuk plotësohet kriteri i proporcionalitetit.* KC-ja e kufizon disponimin e pasurisë me testament në dy mënyra: i) testamenti nuk duhet të cenojë rezervën ligjore; ii) testatori mund të disponojë në favor të cilitdo prej trashëgimtarëve ligjorë, por vetëm brenda tre radhëve të para të trashëgimisë ligjore. Në rastin e kufizimit të dytë, vetëm nëse mungojnë trashëgimtarët e tre radhëve të para, trashëgimlënësi mund t'ua lërë me testament pasurinë e tij kujtdo prej trashëgimtarëve të radhëve të tjera dhe po kështu edhe jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë. Ndërsa në themel të trashëgimisë ligjore qëndron marrëdhënia familjare mes testatorit dhe trashëgimtarëve të tij deri në shkallë të gjashtë e, në mungesë të tyre, më pas trashëgimtar bëhet edhe vetë shteti.

9.2.2. Parashikimi i nenit 377 të KC-së aktuale, pavarësisht ndryshimit të rrethanave politike, ekonomike dhe shoqërore, i përmbahet të njëjtit rregullim të regjimit totalitar. Në ndryshim nga vendet e tjera, zgjidhja e ligjvënësit shqiptar është kufizimi total i mundësisë së disponimit me testament, nëse ka trashëgimtarë ligjorë të tre radhëve të para. Për rrjedhojë, ligjvënësi ka kufizuar mundësinë e disponimit për të gjithë pasurinë trashëgimore dhe jo vetëm për një pjesë të saj. Këtij parashikimi i shtohet edhe kufizimi i rezervës ligjore, prandaj neni 377 i KC-së kufizon në mënyrë absolute lirinë testamentare, duke cenuar vetë thelbin e kësaj të drejte dhe ky kufizim është bërë në mënyrë joproporcionale dhe pa një interes publik.

10. *Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

10.1. *Për legjitimimin:*

10.1.1. Gjykata referuese legjitimohet në kërkesën e saj, pasi ka krijuar bindjen se shqyrtimi i çështjes nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatë dhe se ka bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar normën në përputhje me Kushtetutën. Parashikimi i nenit 377 të KC-së i shoqëruar me nenin 406 të po këtij kodi shërbejnë drejtpërdrejt për zgjidhjen e çështjes. Sipas nenit 377 të KC-së, nuk mund të disponohet tej radhëve të trashëgimtarëve, në rast se ka të tillë. Ndërsa sipas nenit 406 të KC-së ky disponim është i pavlefshëm dhe, rrjedhimisht, për pjesën e testamentit të konstatuar si absolutisht të pavlefshme çëlet trashëgimia ligjore. Gjykata nuk ka mundësi të bëjë interpretim pajtues, veçse duke lënë të pazbatuar një normë të KC-së.

10.2. *Për themelin, neni 377 i KC-së cenon:*

10.2.1. *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në raport me trashëgimlënësin dhe trashëgimtarin. Në kushtet kur trashëgimia përfaqëson një nga format klasike të fitimit të pronësisë, detyrimi i trashëgimlënësit që nëse ka trashëgimtarë të tri radhëve të para të mos mundet të disponojë pasurinë tek të tretët është joproporcional dhe i panevojshëm. Gjithashtu, cenohet edhe *e drejta e pronës e trashëgimtarit* potencial, në rastin konkret, bashkëjetueses.

10.2.2. *Të drejtën për respektimin e jetës familjare*, të garantuar nga nenet 53 e 54 të Kushtetutës, pasi dispozita objekt kundërshtimi i jep një koncept të ngushtë familjes, duke e ngushtuar atë në të paralindur, paslindur, vëllezër dhe motra. Në këtë mënyrë individi kufizohet në dy drejtime, së pari, detyrohet që marrëdhëniet familjare t'i konceptojë e ndërtojë ngushtë dhe, së dyti, pavarësisht dëshirës, për efekt të ligjit, është i detyruar të disponojë pasurinë e tij brenda një rrethi të ngushtë të familjarëve. Pavarësisht se ky cenim është parashikuar me ligj, ai nuk ndjek ndonjë synim legjitim dhe ndërhyrja është joproporcionale dhe e panevojshme.

10.2.3. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi krijohet trajtim jo i barabartë nga pikëpamja e të drejtave pasurore të përfituara midis bashkëshortit/es, që gëzon cilësinë juridike të trashëgimtarit ligjor të radhës së parë dhe bashkëjetuesit/es që nuk e gëzon një cilësi të tillë. Ky trajtim është joproporcional dhe jo i përligjur, në kushtet kur familja krijohet jo vetëm nga martesë, por edhe nga bashkëjetesa. Kjo situatë pabarazie ka ardhur për shkak të ometimit legjislativ, konkretisht të mungesës së ndërhyrjes pozitive nga ana e

ligjvënësit në dispozitat e KC-së që rregullojnë rrethin e trashëgimtarëve ligjorë dhe radhën e thirrjes së tyre në trashëgim.

10.2.4. *Parimin e sigurisë juridike*, në këndvështrim të qartësisë, kuptueshmërisë dhe koherencës së sistemit normativ.

11. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

11.2.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* është i pabazuar, pasi ky kufizim është vendosur me ligj, ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, në rastin konkret të trashëgimtarëve ligjorë të tri radhëve të para. Parimi i lirisë së disponimit me testament nuk është absolut edhe në legjislacionet e tjera. Shfuqizimi i kësaj dispozite do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet familjare, pasi rrethi i trashëgimtarëve do të vendosej në pozita jo të favorshme dhe në pamundësi për të përfituar të drejta pasurore nga trashëgimlënësi.

11.2.2. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *së drejtës për respektimin e jetës familjare*, pasi nga analiza e nenit 53 të Kushtetutës dhe neneve 163 dhe 164 të KF-së, afirmohen si anëtarë të ngushtë të familjes bashkëshortët, bashkëjetuesit dhe fëmijët, ndërsa neni 377 i KC-së nuk e kufizon rrethin e personave që përfitojnë nga trashëgimia vetëm te anëtarët e ngushtë. Qëllimi i institutit të trashëgimisë me testament nuk është të afirmojë konceptin e familjes, por të rregullojë marrëdhëniet juridiko – civile që lindin pas vdekjes së trashëgimlënësit.

11.2.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë përpara ligjit* nuk është i bazuar, pasi neni 377 i KC-së nuk i njeh ndonjë të drejtë bashkëshortit/es pasjetues për të kufizuar vullnetin e trashëgimlënësit, e cila do ta vendoste në pozita diskriminuese bashkëjetuesin/en.

11.2.4. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, neni 377 i KC-së është një dispozitë që ka treguar stabilitet ndër vite, duke mos iu nënshtruar ndryshimeve ligjore që ka pasur ky kod. Për sa i përket pretendimit të përplasjes së neneve 361 dhe 377 të KC-së, nuk është detyrë e Gjykatës të shqyrtojë papajtueshmërinë midis dy ligjeve, por e gjykatave të zakonshme.

12. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

12.1. *Për legjitimimin e gjykatave referuese*

12.1.1. Gjykatat referuese nuk legjitimohen, pasi nuk kanë parashtruar arsye serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës dhe nuk kanë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën.

12.2. *Për themelin:*

12.2.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është i pabazuar, pasi përmbushen kriteret e nenit 17 të Kushtetutës: i) kufizimi është bërë me ligj në drejtim të aspektit formal dhe substancial; ii) ai është bërë për interes publik, pasi parashikimi ligjor ka për qëllim të sigurojë një mënyrë të strukturuar dhe të ligjshme për individët për të disponuar pasurinë e tyre pas vdekjes, një objektiv ligjor i cili lidhet me sigurimin e rendit dhe të stabilitetit në shoqëri. Këto rregulla minimizojnë ndikimin e shtetit në vendimet e individëve dhe autonominë e tyre; iii) në lidhje me kriterin e proporcionalitetit, interpretimi harmonik i dispozitave civile ruan ekuilibrin midis interesave të trashëgimlënësit dhe trashëgimtarëve testamentarë, nga njëra anë, dhe atyre që i përkasin rezervës ligjore, nga ana tjetër, pa cenuar thelbin e së drejtës së testatorit për të disponuar pasurinë e tij, e drejtë e cila nuk mund të jetë e pakufizuar. Zgjidhja legjislative e bërë nga Kuvendi qëndron jashtë juridiksionit kushtetues dhe shfuqizimi i saj mund të krijojë premisa për cenimin e balancës së krijuar në sistemin juridik të trashëgimisë në raport me mbrojtjen ligjore e sociale të institutit të familjes.

12.2.2. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për respektimin e jetës familjare, pasi instituti i bashkëjetesës rregullohet nga KF-ja, i cila parashikon të drejtat dhe detyrimet që burojnë prej tij. Për sa kohë këto norma janë të fuqi, pretendimet e gjykatës referuese nuk gjejnë mbështetje ligjore në kuptim të adresimit të tyre dhe konceptit të *lex specialis derogat lex generalis*. Gjithashtu, pretendimi se neni 377 i KC-së i jep një koncept të ngushtë familjes nuk qëndron, për sa kohë që sigurohen garancitë të cilat i jepen institutit të familjes nga Kushtetuta dhe neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

12.2.3. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, dispozita objekt kundërshtimi nuk krijon diskriminimin e dy kategorive të subjekteve – bashkëshort/bashkëjetues. Sipas përkufizimit të bashkëjetesës nga KF-ja, ajo rregullohet tërësisht sipas vullnetit të palëve, si një marrëdhënie fakti e cila nuk përmban asnjë element juridik. Për sa kohë diferenca

midis këtyre dy instituteve evidentohet në statusin juridik dhe detyrimet dhe të drejtat që derivojnë prej tyre, pretendimi se neni 377 i KC-së sjell diskriminim është i pabazuar.

12.2.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i paqartë, pasi gjykata referuese, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk ka parashtruar argumente për paqartësinë ose pakuptueshmërinë e dispozitës objekt kundërshtimi, të cilat në vetvete mund të sjellin pasoja që bien ndesh me qëllimin e ligjvënësit, e deformojnë atë ose dëmtojnë efektivitetin e tyre. Për sa kohë dispozitat e KF-së që rregullojnë bashkëjetesën nuk i janë nënshtruar kontrollit kushtetues, pretendimet për nenin 377 të KC-së janë me karakter deklarativ dhe të paargumentuara.

13. ***Subjekti i interesuar, Dhoma Kombëtare e Noterisë***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

13.1. Neni 377 i KC-së e kufizon disponimin e pasurisë me testament në aspektin kushtetues të së drejtës së pronës, duke e bërë atë një ndër aktet noteriale më të goditura për pavlefshmëri në gjykatat e zakonshme. Instituti i trashëgimisë në legjislacionin civil nuk u përgjigjet zhvillimeve të kohës, sidomos marrëdhënieve ekonomike në prodhim. Megjithatë, shfuqizimi i kësaj dispozite prish ekuilibrin dhe unitetin harmonik të normave të tjera civile, duke lënë pa kuptim disa prej tyre. Zgjidhja më e përshtatshme do të ishte ndërhyrja e pushtetit legjislativ nëpërmjet nismës ligjore të ndryshimit të institutit të trashëgimisë. Referimi i Gjykatës së Lartë në norma analoge të legjislacioneve të huaja është i gabuar, pasi nuk përkon me frymën e rregullave të sistemit të trashëgimisë në vendin tonë. Kufizimet e lirisë së disponimit me testament janë në përpjesëtim me të drejtën e mbrojtjes që shoqëria u ofron anëtarëve të familjes së trashëgimlënësit. Shfuqizimi i kësaj dispozite do të përmbyste filozofinë e kësaj dege të së drejtës dhe do të sillte liberalizim që kapërcen edhe vendet më të zhvilluara.

13.2. E drejta familjare rregullon marrëdhëniet ndërfamiljare, duke lejuar bashkëjetesat e tjera, por pa garantuar të njëjtën mbrojtje si në martesat ligjore. Objekti dhe qëllimi i saj janë të ndryshëm nga e drejta civile dhe konkretisht rregullimi i së drejtës së trashëgimisë, e cila përfshin një sistem rregullash për pasurinë dhe mënyrat e fitimit të saj.

14. *Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

- 14.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është i bazuar, pasi neni 377 i KC-së përbën kufizim të lirisë së testatorit për të disponuar pasurinë e tij, në kundërshtim me parashikimet kushtetuese dhe konventore, sipas të cilave kushdo ka të drejtë që të gëzojë dhe disponojë lirisht pasurinë e tij. Kjo dispozitë ndalon testatorin, titullar legjitim të të drejtave civile dhe kushtetuese, që pavarësisht respektimit të rezervës ligjore, të disponojë lirisht pasurinë e tij në favor të të tretëve. Interesi publik që i referohet konservimit të familjes ligjore dhe mbrojtjes së fëmijëve të mitur realizohet nga neni 379 i KC-së që parashikon rezervën ligjore, i cili plotëson standardin e një qëllimi të ligjshëm. Ndërsa trashëgimlënësi dhe personat e tretë kufizohen në të drejtën e tyre për të disponuar lirisht pasurinë ose përfituar atë, kategoria e trashëgimtarëve ligjorë që përbëjnë rrethin e familjes gëzojnë mbrojtje absolute nga trashëgimia ligjore dhe nenet 377 e 379 të KC-së. Kufizimi i parashikuar me dispozitën e kundërshtuar nuk respekton parimin e proporcionalitetit, në kushtet kur partnerët faktikë ose çdo person i tretë përjashtohen nga trashëgimia me testament.
- 14.2. I bazuar është edhe pretendimi për *respektimin e jetës familjare*, pasi dispozita imponon “lidhjen e gjakut” si kriter ekskluziv, pa marrë parasysh “lidhjen afektive ose faktike” që trashëgimlënësi ka pasur me persona të tretë. Në këtë mënyrë, familjes ligjore i bëhet një trajtim më i privilegjuar se familja faktike, megjithatë kjo nuk nënkupton mungesën absolute të të drejtave të kësaj të fundit. Gjithashtu, cenohet edhe *parimi i mosdiskriminimit dhe barazisë përpara ligjit*.
- 14.3. Edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i bazuar, pasi norma është e paqartë dhe jo në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon të arrijë. Balancimi i autonomisë së vullnetit të testatorit dhe interesit publik për të mbrojtur institutin e familjes dhe përmbushur objektivat sociale realizohet nga neni 379 i KC-së, i cili përcakton rezervën ligjore dhe trashëgimtarët e detyrueshëm. Pavarësisht këtij rregullimi, neni 377 i KC-së e ka kufizuar lirinë e testatorit në mënyrë maksimale, kushtëzuese dhe të dyfishtë, parashikim i cili nuk gjendet as në legjislacionet e tjera evropiane. Këto të fundit kanë parashikuar një kuotë të caktuar, të cilën trashëgimlënësi mund ta disponojë pa kufizim. Referuar dispozitës së kundërshtuar, testatori gjendet në pamundësi absolute të disponojë jashtë

rrethit të trashëgimtarëve të përcaktuar në këtë nen qoftë edhe një pjesë minimale të pasurisë së tij. Ky kufizim shtrihet më tej edhe në nenin 384 të KC-së që parashikon të drejtën e legut.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatave referuese

15. Gjykatat referuese, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se legjitimohen për paraqitjen e kontrollit incidental, pasi kanë identifikuar ligjin (nenin 377 të KC-së) që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes, kanë krijuar bindjen se gjykimi nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga kontrolli kushtetues i dispozitës së kundërshtuar, kanë parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e tij, si dhe është e pamundur të bëhet një interpretim pajtues i saj.

16. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se gjykatat referuese nuk legjitimohen, pasi nuk kanë parashtruar arsye serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës dhe nuk kanë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën.

17. Çështja e legjitimitit të subjekteve (*locus standi*) që mund t'i drejtohen Gjykatës është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që mundëson nisjen e procesit kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental parashikohet në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës, i cili u njeh të drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, të vendosin pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e normës. Kjo dispozitë, e konkretizuar edhe në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, lidhet me kontrollin kushtetues të ligjeve nga Gjykata, kur ky kontroll kërkohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

18. Për sa i takon legjitimitit të gjykatës referuese që vë në lëvizje kontrollin incidental të kushtetutshmërisë së normës ligjore, bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, të konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka zhvilluar disa kriteret kumulative, sipas të cilave, gjykata referuese duhet që gjatë gjykimit që zhvillohet pranë saj: (i) të ketë identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e tij dhe të ketë krijuar bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja në Gjykatë - pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; (ii) të ketë parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e ligjit,

duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; (iii) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 32 datë 30.05.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 8, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Lidhur me kriterin e parë të legjitimitit, Gjykata ka theksuar se gjykata referuese duhet të arsyetojë efektin e drejtpërdrejtë që ka dispozita e kundërshtuar për gjykimin pranë saj, duke individualizuar se pikërisht ajo dispozitë zbatohet dhe zgjidh mosmarrëveshjen konkrete pranë saj. Kjo nënkupton se kriteri për identifikimin e dispozitave ligjore, që gjykata referuese çmon se bien ndesh me Kushtetutën, nuk konsiderohet i plotësuar thjesht me paraqitjen e tyre formalisht në kërkesë, pasi ato duhet të jenë identifikuar dhe individualizuar se zgjidhin mosmarrëveshjen konkrete pranë saj. Dispozita e kundërshtuar duhet të ketë lidhje me gjykimin në gjykatën referuese në atë masë që ai nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur pa u shqyrtuar nga Gjykata kushtetutshmëria e dispozitës ligjore (*shih vendimet nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 1, datë 26.01.2021; nr. 30, datë 25.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këtë drejtim, gjykata referuese, Gjykata e Lartë, ka parashtruar se ligji që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete është neni 377 i KC-së, i cili përcakton dhe rregullon në mënyrë specifike caktimin e trashëgimitarit testamentar, duke ndaluar disponimin me testament të pasurisë në favor të një personi të tretë, për aq kohë sa trashëgimlënësi ka lënë trashëgimtarë ligjorë të përcaktuar nga kjo dispozitë. Ajo ka krijuar edhe bindjen se gjykimi nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatë. Edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka parashtruar se parashikimi i nenit 377 të KC-së i shoqëruar me nenin 406 të po këtij kodi shërbejnë drejtpërdrejt për zgjidhjen e çështjes. Sipas kësaj gjykate, bazuar në këtë nen, nuk mund të disponohet tej radhëve të trashëgimtarëve, në rast se ka të tillë, ndërsa sipas nenit 406 të KC-së ky disponim është i pavlefshëm dhe rrjedhimisht për pjesën e testamentit të konstatuar si absolutisht të pavlefshme çelet trashëgimia ligjore. Për rrjedhojë, edhe kjo gjykatë ka krijuar bindjen se shqyrtimi i çështjes nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatë.

21. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka në shqyrtim çështjen me objekt kërkim trashëgimie, ku sipas rrethanave rezulton se një trashëgimlënësi ka disponuar pasurinë e saj me testament, duke caktuar si trashëgimtar të vetëm nipin e bashkëshortit të saj. Trashëgimtarja e vetme ligjore e trashëgimlënëses, duke mos qenë dakord me këtë disponim, i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me pretendimin se testamenti është në kundërshtim me

nenin 377 të KC-së. Kjo është edhe dispozita ligjore e identifikuar nga Gjykata e Lartë si dispozita e zbatueshme në gjykimin e mosmarrëveshjes civile përpara saj, e cila ndalon disponimin me testament të pasurisë në favor të një personi të tretë, për sa kohë trashëgimlënësi ka lënë trashëgimtarë ligjorë. Po kështu, edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka në shqyrtim një tjetër çështje me objekt konstatimin pjesërisht të pavlefshmërisë absolute të testamentit të një shtetasi, i cili ka caktuar si trashëgimtarë bashkëjetuesen dhe djalin e tij të mitur, duke identifikuar nenin 377 të KC-së si dispozitë të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes në lidhje me nenin 406 të KC-së, sipas të cilit disponimi tej radhëve të trashëgimtarëve të parashikuar në nenin 377 të po këtij kodi është absolutisht i pavlefshëm.

22. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se gjykatat referuese kanë përmbushur kriterin e identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë që kushtetutshmëria e tij ka me gjykimin e çështjeve për shqyrtim përpara tyre, për sa kohë që dispozita e nenit 377 të KC-së është e zbatueshme për zgjidhjen e çështjeve objekt gjykimi në ato gjykata.

23. Në lidhje me kriterin e dhënies së arsyeve bindëse për antikushtetutshmërinë e ligjit, Gjykata rithekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ajo nisët nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën, që do të thotë se argumentet e parashtruara duhet të jenë bindëse, për t'i dhënë mundësi kësaj Gjykate të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 5, datë 27.01.2017; nr. 52, datë 26.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykatat referuese kanë parashtruar se neni 377 i KC-së cenon të drejtën e pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Ky kufizim është bërë në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, pasi nuk respekton kriterin e interesit publik dhe nuk është proporcional. Gjithashtu, kjo dispozitë cenon edhe parimin e sigurisë juridike, të drejtën për jetën familjare dhe parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuara nga nenet 4, 18 dhe 53 të Kushtetutës, pasi nuk përmbush elementet e qartësisë, kuptueshmërisë dhe koherencës së sistemit normativ, i jep një koncept të ngushtë familjes dhe trajton në mënyrë jo të barabartë dy kategori të familjes, bashkëshortin/en dhe bashkëjetuesin/en.

25. Gjykata vëren se të dyja gjykatat referuese kanë argumentuar se ndalimi i disponimit me testament të pasurisë në favor të një personi të tretë, për aq kohë sa trashëgimlënësi ka lënë trashëgimtarë ligjorë, kufizon të drejtat dhe liritë e tij themelore dhe njëkohësisht ndikon në çekuilibrimin e marrëdhënieve familjare dhe shoqërore. Sipas tyre, për shkak të paqartësisë,

mungesës së kuptueshmërisë, por dhe përshtatjes me zhvillimet e institucionit të familjes, dispozita e kundërshtuar cenon të drejtat kushtetuese të trashëgimlënësit, të garantuara nga nenet 4, 18 dhe 53 të Kushtetutës.

26. Mbështetur në argumentet e lartpërmendura, Gjykata çmon se gjykatat referuese kanë arsyetuar vendimet me të cilat kanë bazuar kërkesën për kontroll incidental dhe kanë dhënë arsye të mjaftueshme për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, për rrjedhojë, përkundër pretendimit të subjektit të interesuar, ato e kanë përmbushur edhe këtë kriter.

27. Lidhur me kriterin për përpjekjet e gjykatës për ta interpretuar dispozitën ligjore të kundërshtuar në përputhje me Kushtetutën, Gjykata ka theksuar se vetëm në rast se gjyqtari referues vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si të zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka parashtruar se është e pamundur të bëhet një interpretim pajtues i normës me Kushtetutën, pasi neni 377 i KC-së është kategorik në rregullimin e tij si një dispozitë e mbyllur që nuk lë asnjë shteg për interpretim të zgjeruar dhe, ajo është interpretuar në këtë mënyrë vazhdimisht nga gjykatat që nga viti 1994. Për rrjedhojë, sipas Gjykatës së Lartë, është e pamundur që ajo t'i japë kuptim të ndryshëm normës pa cenuar parimin e ndarjes së pushteteve, të sigurisë juridike dhe atij të barazisë përpara ligjit. Edhe gjykata tjetër referuese është shprehur se ka bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar normën në përputhje me Kushtetutën, por parashikimi i nenit 377 të KC-së i shoqëruar me nenin 406 të po këtij kodi shërbejnë drejtpërdrejt për zgjidhjen e çështjes dhe ajo nuk ka mundësi të bëjë interpretim pajtues, veçse duke lënë të pazbatuar një normë të KC-së.

29. Gjykata vëren se ndonëse të dyja gjykatat kanë bërë përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjet objekt gjykimi, sërish kjo ka qenë e pamundur për shkak të përcaktimit shterues të dispozitës së kundërshtuar. Për rrjedhojë, ajo vlerëson se të dyja gjykatat referuese e kanë përmbushur edhe këtë kriter. Për më tepër, Gjykata çmon se kjo çështje nuk mund të zgjidhet as nëpërmjet vendimmarrjes unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe kjo vërtetohet jo vetëm nga fakti se vetë kjo gjykatë ka vlerësuar të parashtrrojë çështjen e antikushtetutshmërisë së normës nëpërmjet kontrollit incidental, por sidomos duke mbajtur në konsideratë se, pavarësisht

se neni 377 i KC-së është në fuqi prej vitit 1994, Gjykata e Lartë nuk ka marrë ndonjëherë një vendim unifikues në lidhje me të.

30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se gjykatat referuese plotësojnë kriteret e legjitimitit, në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000, ndaj, në vijim, do të kontrollojë themelin e pretendimeve lidhur me kushtetutshmërinë e nenit 377 të KC-së.

31. Për sa i takon themelit të pretendimeve, Gjykata vëren se gjykatat referuese kanë pretenduar se dispozita e kundërshtuar cenon të drejtën e pronës private dhe bie në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës, në drejtim të interesit publik dhe proporcionalitetit, të drejtën për respektimin e jetës familjare, parimin e barazisë përpara ligjit dhe parimin e sigurisë juridike, në këndvështrim të qartësisë, kuptueshmërisë dhe koherencës së sistemit normativ, të cilat janë me natyrë kushtetuese dhe, si të tilla, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Mbështetur në thelbin e argumenteve të këtyre pretendimeve, Gjykata çmon se pretendimet që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës së pronës private dhe parimit të sigurisë juridike t'i analizojë të lidhura me njëra-tjetrën në drejtim të nenit 41 të Kushtetutës, i parë së bashku me nenin 17 të saj, ndërsa pretendimet për të drejtën për jetë familjare dhe parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit t'i analizojë në kuptim të këtij të fundit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së pronës private të lidhur me parimin e sigurisë juridike

32. Gjykatat referuese kanë pretenduar se kufizimi i së drejtës së pronës private është bërë në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Edhe pse kriteri i kufizimit me ligj është respektuar në rastin konkret, nuk respektohet kriteri i interesit publik, veçanërisht referuar nenit 201 të KF-së, sipas të cilit detyrimi për ushqim nuk është kategorik dhe përfundon pas arritjes së një moshe të caktuar. Për rrjedhojë, nuk ka asnjë interes publik që trashëgimia të kalojë tek fëmijët që janë mbi këtë moshë, përderisa prindi nuk ka më asnjë detyrim ligjor. Ndërkohë që fëmijët e mitur në trashëgimi mbrohen nga ana e parashikimeve të rezervës ligjore që është një tjetër kufizim që rrjedh nga KC-ja. Parashikimi i nenit 377 të KC-së nuk plotëson kriterin që kufizimi të jetë proporcional. KC-ja e kufizon disponimin e pasurisë me testament në dy mënyra: i) testamenti nuk duhet të cenojë rezervën ligjore; ii) testatori mund të disponojë në favor të cilitdo prej trashëgimtarëve ligjorë, por vetëm brenda tre radhëve të para të trashëgimisë ligjore.

Në rastin e kufizimit të dytë, vetëm nëse mungojnë trashëgimtarët e tre radhëve të para, trashëgimlënësi mund t'ia lërë me testament pasurinë e tij kujt do prej trashëgimtarëve të radhëve të tjera, e po kështu edhe jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë. Parashikimi i nenit 377 të KC-së aktuale është frymëzuar nga legjislacioni i kohës së regjimit totalitar dhe në ndryshim nga vendet e tjera, zgjidhja që ka bërë ligjvënësi shqiptar në nenin 377 të KC-së është kufizimi total i mundësisë së disponimit me testament, nëse ka trashëgimtarë ligjorë të tre radhëve të para. Gjithashtu, neni 377 cenon parimin e sigurisë juridike në këndvështrim të qartësisë, kuptueshmërisë dhe koherencës së sistemit normativ.

33. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se kufizimi i së drejtës së pronës në nenin 377 të KC-së është vendosur me ligj dhe ka qëllim mbrojtjen e të drejtave të tjerëve, në rastin konkret të trashëgimtarëve ligjorë të tri radhëve të para. Parimi i lirisë së disponimit me testament nuk është absolut edhe në legjislacionet e tjera. Shfuqizimi i kësaj dispozite do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet familjare, pasi rrethi i trashëgimtarëve do të vendosej në pozita jo të favorshme dhe në pamundësi për të përfituar të drejta pasurore nga trashëgimlënësi.

34. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se përmbushen kriteret e nenit 17 të Kushtetutës: *Së pari*, ai i kufizimit me ligj në drejtim të aspektit formal dhe substancial të dispozitës së kundërshtuar. *Së dyti*, kufizimi për interes publik, pasi parashikimi ligjor ka për qëllim të sigurojë një mënyrë të strukturuar dhe të ligjshme për individët për të disponuar pasurinë e tyre pas vdekjes, një objektiv ligjor i cili lidhet me sigurimin e rendit dhe stabilitetit në shoqëri. Këto rregulla minimizojnë ndikimin e shtetit në vendimet e individëve dhe autonominë e tyre. *Së treti*, në lidhje me kriterin e proporcionalitetit, interpretimi harmonik i dispozitave civile ruan ekuilibrin midis interesave të trashëgimlënësit dhe trashëgimtarëve testamentarë, nga njëra anë, dhe atyre rezervatarë, nga ana tjetër, pa cenuar thelbin e së drejtës së testatorit për të disponuar pasurinë e tij, e drejtë e cila nuk mund të jetë e pakufizuar. Zgjidhja legjislative e bërë nga Kuvendi qëndron jashtë juridiksionit kushtetues dhe shfuqizimi i saj mund të krijojë premisa për cenimin e balancës së krijuar në sistemin juridik të trashëgimisë në raport me mbrojtjen ligjore e sociale të institutit të familjes.

35. Subjekti i interesuar, Dhoma Kombëtare e Noterisë, ka prapësuar se neni 377 i KC-së e kufizon disponimin e pasurisë me testament në aspektin kushtetues të së drejtës së pronës, duke e bërë atë një ndër aktet noteriale më të goditura për pavlefshmëri në gjykatat e zakonshme. Instituti i trashëgimisë në legjislacionin civil nuk u përgjigjet zhvillimeve të kohës, sidomos

marrëdhënieve ekonomike në prodhim. Megjithatë, shfuqizimi i kësaj dispozite prish ekuilibrin dhe unitetin harmonik të normave të tjera civile, duke lënë pa kuptim disa prej tyre. Zgjidhja më e përshtatshme do të ishte ndërhyrja e pushtetit legjislativ nëpërmjet nismës ligjore të ndryshimit të institutit të trashëgimisë. Referimi i Gjykatës së Lartë në norma analoge të legjislacioneve të huaja është i gabuar, pasi nuk përkon me frymën e rregullave të sistemit të trashëgimisë në vendin tonë. Kufizimet e lirisë së disponimit me testament janë në përpjesëtim me të drejtën e mbrojtjes që shoqëria u ofron anëtarëve të familjes së trashëgimlënës. Shfuqizimi i kësaj dispozite do të përmbyste filozofinë e kësaj dege të së drejtës dhe do të sillte liberalizim që kapërcen edhe vendet më të zhvilluara.

36. Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit, ka prapësuar se neni 377 i KC-së përbën kufizim të lirisë së testatorit për të disponuar pasurinë e tij, në kundërshtim me parashikimet kushtetuese dhe konventore, sipas të cilave kushdo ka të drejtë të gëzojë dhe disponojë lirisht pasurinë e tij. Kjo dispozitë ndalon testatorin, titullar legjitim të të drejtave civile dhe kushtetuese, që pavarësisht respektimit të rezervës ligjore, të disponojë lirisht pasurinë e tij në favor të të tretëve. Interesi publik që i referohet konservimit të familjes ligjore dhe mbrojtjes së fëmijëve të mitur realizohet nga neni 379 i KC-së që parashikon rezervën ligjore, i cili plotëson standardin e një qëllimi të ligjshëm. Ndërkohë që trashëgimlënësi dhe personat e tretë kufizohen në të drejtën e tyre për disponuar lirisht pasurinë ose përfituar atë, kategoria e trashëgimtarëve ligjorë që përbëjnë rrethin e familjes gëzojnë mbrojtje absolute nga trashëgimia ligjore dhe nenet 377 e 379 të KC-së. Kufizimi i parashikuar me dispozitën e kundërshtuar nuk respekton parimin e proporcionalitetit, në kushtet kur partnerët faktikë ose çdo person i tretë përjashtohen nga trashëgimia me testament.

37. Kushtetuta, në nenin 41, pika 1, ka parashikuar se e drejta e pronës private është e garantuar, duke përcaktuar në pikën 2 të tij se trashëgimia përbën një nga mënyrat e fitimit të pronësisë. Ndërsa Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se garantimi i së drejtës së pronës private përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. E drejta e pronës realizohet përmes ushtrimit të tagrave të pronësisë, ndërmjet të cilave është edhe e drejta për të disponuar pronën dhe se cenimi qoftë edhe i pjesshëm i çdo tagri të pronësisë përbën në vetvete cenimin e së drejtës të pronës në tërësinë e saj (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kriterëve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin

17 të Kushtetutës. Prandaj, në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet respektimi i kësaj të drejte pa pengesa të paarsyeshme ose joproportionale (*shih vendimet nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 36 datë 21.04.2017; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjykata konstaton se testamenti përbën një nga mënyrat e disponimit të pronësisë për shkak të vdekjes (*mortis causa*), në dallim nga mënyrat e tjera të disponimit të saj gjatë jetës së trashëgimlënësit (*inter vivos*). Testamenti shfaqet si një akt i vullnetshëm i trashëgimlënësit, i cili zgjedh të kalojë pasurinë e tij (*tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve pasurore*) në një kategori personash të zgjedhur prej tij. Në këtë kuptim, e drejta për të disponuar me testament ka për qëllim të sigurojë transferimin e së drejtës së pronësisë sipas vullntit të lirë të trashëgimlënësit edhe pas vdekjes së tij. Kjo do të thotë se testamenti, në thelb, përbën një mekanizëm për të parandaluar që prona private, si baza e një stili jetese që përcaktohet nga vetë individi, të përfundojë me vdekjen e pronarit dhe siguron vazhdimësinë e saj nëpërmjet trashëgimisë. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se e drejta e disponimit të pasurisë me testament është e pakufizuar, prandaj, në këto kushte, mbetet detyrë e ligjvënësit të ndërhyjë për të bërë rregullimet përkatëse.

39. Sikurse ka theksuar edhe Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë në jurisprudencën e saj, e drejta për të disponuar me testament plotëson të drejtën e pronësisë, por mbetet në diskrecionin e legjislatorit për të përcaktuar kufijtë e kësaj të drejte. Megjithëse e drejta e pronës dhe ajo për të disponuar me testament janë të ndërlidhura, kjo e fundit nuk garanton në mënyrë të pakushtëzuar të drejtën për të transferuar pasurinë *ex causa mortis* te palët e treta, për rrjedhojë diskrecioni i legjislatorit për të kufizuar atë është më i madh se kufizimi i së drejtës së pronësisë (*shih vendimin e Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë 1 BvR 1644/00, 1 BvR 188/03, datë 19 prill 2005*).

40. Rregullimi ligjor i trashëgimisë me testament në legjislacionin shqiptar parashikohet në Pjesën III, titulli III, të KC-së. Kështu, në kuptim të nenit 372 të KC-së, në parim, trashëgimlënësi është i lirë të disponojë pasurinë e tij pas vdekjes, ndërkohë që neni 377 i KC-së përcakton se trashëgimlënësi mund të disponojë në favor të cilitdo prej trashëgimtarëve ligjorë, por vetëm brenda tre radhëve të para të trashëgimisë ligjore dhe vetëm nëse mungojnë trashëgimtarët e tre radhëve të para, trashëgimlënësi mund t'ia lërë me testament pasurinë e tij kujtdo prej trashëgimtarëve të radhëve të tjera, e po kështu edhe jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë. Përkundër kësaj, neni 360 i KC-së, i cili rregullon trashëgiminë me ligj, përcakton si

trashëgimtarë ligjorë të afërmit deri në shkallën e gjashtë, sipas radhës së caktuar në dispozitat vijuese.

41. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se parashikimi i nenit 377 të KC-së përbën kufizim në të drejtën e trashëgimlënësit për të disponuar pronën e tij lirisht pas vdekjes, jo vetëm te personat jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë, por edhe brenda këtyre të fundit. Gjithashtu, nisur nga sa më lart, e drejta e trashëgimisë, e cila përmendet shprehimisht në nenin 41 të Kushtetutës si mënyrë e fitimit të pronësisë, e plotëson dhe ndërlidhet me këtë të fundit, në kuptimin që së bashku formojnë themelin e sistemit të pronës private. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se garancitë kushtetuese të nenit 41 të Kushtetutës gjejnë zbatim edhe për të drejtën për të disponuar me testament, që është pjesë e së drejtës së trashëgimisë. Prandaj në vijim, do të vlerësohet nëse kufizimi i së drejtës për të disponuar pasurinë me testament u përgjigjet kriterëve të nenit 17 të Kushtetutës.

i. Për kriterin e kufizimit me ligj

42. Kriteri i parë për t'u analizuar është “*kufizimi vetëm me ligj*” i të drejtave dhe lirive të individit, i cili pranohet se është përmbushur si nga gjykatat referuese, ashtu edhe nga subjektet e interesuara. Edhe në vlerësimin e Gjykatës, duke qenë se kufizimi parashikohet nga përmbajtja e nenit 377 të KC-së, referuar nenit 17 të Kushtetutës, ky kriter rezulton të jetë respektuar, si në aspektin formal, ashtu edhe substancial.

ii. Për kriterin e ekzistencës së interesit publik

43. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e aktit konkret që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyes publike që çojnë në kufizimin e një të drejte themelore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 16, datë 01.03.2017; nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Në veçanti për të drejtën e pronës private, sipas nenit 41 të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se garantimi i saj përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike dhe

askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik (*shih vendimin nr. 36, datë 21.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim vihet në dukje se në rastin e kufizimeve të së drejtës së pronës, identifikimi i interesit publik përbën faktor përcaktues, pasi sipas nenit 41, pika 3, të Kushtetutës ligji mund të parashikojë kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë. Theksimi për herë të dytë i interesit publik në tekstin e kësaj dispozite, krahas atij të nenit 17 të Kushtetutës, me fushë zbatimi për të gjitha të drejtat dhe liritë themelore që mund të kufizohen, është tregues i rëndësisë së veçantë që kushtetutëbërësi i ka dhënë së drejtës së pronës. Nga ana tjetër, përcaktimi i shprehur i interesit publik si shkak për kufizimin e kësaj të drejte tregon se Gjykata duhet të kontrollojë me kujdes të shtuar vlerësimin që pushteti ekzekutiv dhe ai ligjvënës i bëjnë interesit publik (*shih vendimet nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 30 datë 02.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjykatat referuese kanë parashtruar se dispozita e kundërshtuar nuk respekton kriterin e interesit publik dhe kufizimi nuk ndjek ndonjë synim legjitim. Sipas tyre, nuk ka asnjë interes publik që trashëgimia të kalojë tek fëmijët që kanë mbushur moshën madhore, përderisa prindi nuk ka më asnjë detyrim ligjor. Ndërkohë që fëmijët e mitur në trashëgimi mbrohen nga parashikimet e rezervës ligjore, që është një tjetër kufizim që rrjedh nga KC-ja. Po kështu, në rast disponimi me testament ka kufizime kategorike për disponimin e pasurisë, megjithëse vëllezërit dhe motrat mund të mos jenë në kushtet e nevojës.

46. Në të kundërt, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se kufizimi është bërë për interes publik, pasi parashikimi ligjor ka për qëllim të sigurojë një mënyrë të strukturuar dhe të ligjshme për individët për të disponuar pasurinë e tyre pas vdekjes, një objektiv ligjor i cili lidhet me sigurimin e rendit dhe stabilitetit në shoqëri. Këto rregulla minimizojnë ndikimin e shtetit në vendimet e individëve dhe autonominë e tyre. Ndërsa, subjekti tjetër i interesuar, Avokati i Popullit, ka prapësuar se interesi publik që i referohet konservimit të familjes ligjore dhe mbrojtjes së fëmijëve të mitur realizohet nga neni 379 që parashikon rezervën ligjore, i cili plotëson standardin e një qëllimi të ligjshëm.

47. Gjykata, mbështetur në standardet kushtetuese të lartpërmendura, si dhe për të analizuar vlerësimin që ligjvënësi i ka bërë interesit publik, çmon të ndalet fillimisht në vështrimin historik të normimit të trashëgimisë me testament në legjislacionin shqiptar. Kështu, KC-ja e vitit 1929 në nenet 454-773 përcaktonte trashëgiminë me ligj dhe atë me testament. Testamenti konsiderohej si një akt i revokueshëm, me të cilin kushdo, sipas rregullave të

përcaktuar në ligj, dispononte për kohën pas vdekjes të gjithë ose një pjesë të pasurisë në favor të një ose më shumë personave. Sipas nenit 537 të këtij kodi *“testatori që nuk lën as të paslindun, as të parëlindun, as vllazën ose motra, mundet me disponue gjithë pasunien e vetë me titull universal ose partikollar. Por mbeten të palëndueme të drejtat e bashkëshortit pasjetues dhe të fëmijëve natyralë simbas seksionit II”*.

48. Më pas, me vendosjen e regjimit totalitar në Shqipëri, u miratua dekreti nr. 1892, datë 05.07.1954 *“Mbi trashëgiminë”*, i cili në nenin 32 parashikonte se trashëgimlënësi mund t’i lërë me testament të gjithë pasurinë e tij ose një pjesë të saj, një ose më shumë trashëgimtarëve nga ata që tregohen në nenet 21, 22 dhe 23, shtetit ose organeve të tjera dhe organizatave shoqërore. Kur trashëgimlënësi nuk ka asnjë nga trashëgimtarët që tregohen në ato nene, mund t’ia lërë pasurinë e tij çdo njeriu. Me miratimin e KC-së në vitin 1981, në nenin 112 parashikohej se *“trashëgimlënësi mund t’u lërë me testament të gjithë pasurinë e tij ose një pjesë të saj, një trashëgimtar i a më shumë trashëgimtarëve nga ata që përcaktohen në nenet 104, 105 dhe 106, shtetit ose ndërmarrjeve, institucioneve, kooperativave bujqësore ose organizatave shoqërore. Kur trashëgimlënësi nuk ka asnjë nga trashëgimtarët që tregohen në nenet 104, 105 dhe 106, ai mund t’ia lërë pasurinë e tij çdo personi”*.

49. Pas hyrjes në fuqi në vitin 1994 të KC-së, trashëgimia me testament gjeti parashikim në nenet 372 – 418. Dispozita objekt kontrolli, neni 377 i KC-së, por edhe dispozitat e tjera të këtij instituti, pavarësisht ndërhyrjeve të ndryshme ndër vite nga ligjvënësi në KC, rezulton se nuk kanë pësuar ndryshime nga formulimi fillestar.

50. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se kufizimet e së drejtës së pronës në drejtim të lirisë së disponimit me testament, të përcaktuara nga neni 377 i KC-së, janë vendosur për të mbrojtur brenda marrëdhënieve familjare, të drejtat e një rrethi të caktuar të trashëgimtarëve ligjorë, për shkak të mbrojtjes së veçantë që neni 53 i Kushtetutës i ka garantuar familjes, qëndrueshmëria e së cilës përbën njësinë bazë të organizimit shoqëror të vendit. Në këtë rast ballafaqohen interesat e një rrethi të gjerë familjar me lidhje gjaku me një kategori më të vogël, e cila karakterizohet nga lidhjet më afektive me trashëgimlënësin. Një mbrojtje të veçantë kanë edhe fëmijët, sipas parashikimeve të nenit 54 të Kushtetutës, për të cilët ligjvënësi ka parashikuar edhe detyrimin për ushqim, jo vetëm derisa ata arrijnë moshën madhore, por edhe deri në moshën 25 vjeç, nëse vazhdojnë studimet (neni 197 i KF-së). Prandaj Gjykata çmon se dispozita, duke përcaktuar mënyrën e disponimit të pasurisë pas vdekjes, synon të mbrojë rrethin

e ngushtë familjar dhe ka për qëllim garantimin e rendit juridik dhe stabilitetin e marrëdhënieve juridike në shoqëri.

51. Nën këtë analizë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja në mënyrën e disponimit të së drejtës së pronës private të testatorit i përgjigjet interesit publik, prandaj përmbushet edhe kriteri i dytë i parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës.

iii. Për kriterin e proporcionalitetit

52. Mbështetur në nenin 17 të Kushtetutës, kriteri tjetër për kufizimin e të drejtave themelore është përpjesëtimi i drejtë midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e dikton atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave, e në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe të proporcionalitetit (*shih vendimet nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 2, datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 16, datë 01.03.2017; nr. 1, datë 06.02.2013; nr. 52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Gjykata ka evidentuar se për vlerësimin e proporcionalitetit duhen mbajtur në konsideratë disa kritere: (i) nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh që kriteret e mësipërme të mos analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën (*shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata thekson se në shqyrtimin e proporcionalitetit duhen mbajtur parasysh një numër faktorësh, të cilët nuk mund të përcaktohen në mënyrë shteruese. Ata ndryshojnë rast pas rasti, në varësi të fakteve të çështjes dhe të natyrës së ndërhyrjes që ka kufizuar të drejtën themelore.

54. Gjykatat referuese kanë parashtruar se ligjvënësi ka kufizuar mundësinë e disponimit për të gjithë pasurinë trashëgimore dhe jo vetëm për një pjesë të saj. Këtij parashikimi i shtohet edhe kufizimi i rezervës ligjore, prandaj neni 377 i KC-së kufizon në mënyrë absolute lirinë testamentare, duke cenuar vetë thelbin e kësaj të drejte dhe ky kufizim është bërë në mënyrë joproporcionale dhe të panevojshme. Trajtimi i të drejtave pasurore të përfituara midis bashkëshortit/es, që gëzon cilësinë juridike të trashëgimtarit ligjor të radhës së parë dhe bashkëjetuesit/es, që nuk e gëzon një cilësi të tillë, është joproporcional dhe jo i përligjur në kushtet kur familja krijohet jo vetëm nga martesë, por edhe nga bashkëjetesa.

55. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se interpretimi harmonik i dispozitave civile ruan ekuilibrin midis interesave të trashëgimlënësit dhe trashëgimtarëve testamentarë, nga njëra anë, dhe atyre që i përkasin rezervës ligjore, nga ana tjetër, pa cenuar thelbin e së drejtës së testatorit për të disponuar pasurinë e tij, e drejtë e cila nuk mund të jetë e pakufizuar. Instituti i bashkëjetesës rregullohet nga KF-ja, e cila parashikon të drejtat dhe detyrimet që burojnë prej tij. Për sa kohë këto norma janë në fuqi, pretendimet e gjykatës referuese nuk gjejnë mbështetje ligjore në kuptim të adresimit të tyre dhe konceptit të *lex specialis derogat lex generalis*. Për sa kohë dispozitat e KF-së që rregullojnë bashkëjetesën nuk i janë nënshtruar kontrollit kushtetues, pretendimet për nenin 377 të KC-së janë me karakter deklarativ dhe të paargumentuara. Zgjidhja legjislative e bërë nga Kuvendi qëndron jashtë juridiksionit kushtetues dhe shfuqizimi i tij mund të krijojë premisa për cenimin e balancës së krijuar në sistemin juridik të trashëgimisë në raport me mbrojtjen ligjore e sociale të institutit të familjes. Po kështu, edhe sipas subjektit tjetër të interesuar, Dhomës Kombëtare të Noterisë, kufizimet e lirisë së disponimit me testament janë në përpjesëtim me të drejtën e mbrojtjes që shoqëria u ofron anëtarëve të familjes së trashëgimlënësit. Shfuqizimi i kësaj dispozite do të përmbyste filozofinë e kësaj dege të së drejtës dhe do të sillte liberalizim që kapërcen edhe vendet më të zhvilluara. Ndërsa sipas subjektit të interesuar, Avokatit të Popullit, kufizimi i parashikuar me dispozitën e kundërshtuar nuk respekton parimin e proporcionalitetit, në kushtet kur partnerët faktikë ose çdo person i tretë përjashtohet nga trashëgimia me testament.

56. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se rregullat e nenit 377 të KC-së, që përcaktojnë kategorinë e rrethit të trashëgimtarëve testamentarë, kufizojnë në thelb të drejtën e trashëgimlënësit për të disponuar sipas vullnetit të tij pronën pas vdekjes. Krahas kësaj dispozite, neni 379 i KC-së parashikon detyrimin e trashëgimlënësit të respektojë rezervën ligjore, duke

përcaktuar se trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim, si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë, në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament, në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar. Gjithashtu, neni 371 i KC-së konsideron si trashëgimtarë të paaftë për punë ata që nuk ka mbushur moshën 16 vjeç ose 18 vjeç kur vazhdojnë mësimet, burrat që kanë mbushur moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç, si dhe pavarësisht nga mosha, ata që janë invalidë të grupit të parë dhe të grupit të dytë. Nisur nga këto parashikime, nenet 377 dhe 379 të KC-së të lexuara së bashku passjellin kufizimin e disponimit të pasurisë me testament në dy drejtime: i) testamenti nuk duhet të cenojë rezervën ligjore; ii) testatori mund të disponojë në favor të cilitdo prej trashëgimtarëve ligjorë, por vetëm brenda tre radhëve të para të trashëgimisë ligjore dhe në këtë rast, vetëm nëse mungojnë trashëgimtarët e tri radhëve të para, trashëgimlënësi mund t'ia lërë me testament pasurinë e tij kujtdo prej trashëgimtarëve të radhëve të tjera, e po kështu edhe jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë.

57. Nga sa më lart, duke qenë se në themel të konceptit të testamentit qëndron mundësia ligjore që trashëgimlënësi të shprehë vullnetin e tij të lirë për të disponuar për pasurinë edhe pas vdekjes së tij, për të përcaktuar nëse kufizimi i parashikuar nga neni 377 i KC-së është proporcional, vlerësohet e arsyeshme, fillimisht, nën dritën e një këndvështrimi krahasues, analiza historike e lartpërmendur e legjislacionit shqiptar dhe e legjislacioneve të vendeve të ndryshme evropiane në lidhje me të drejtën për të disponuar me testament.

58. Bazuar në qasjen historike të lartpërmendur të dispozitës në shqyrtim (*shih paragrafët 47-49 më sipër*), Gjykata evidenton se kufizimi i së drejtës për të disponuar me testament ka ndjekur të njëjtin model me regjimin e mëparshëm. Pavarësisht hyrjes në fuqi të KC-së aktuale dhe kalimit nga një shtet që bazohej në pronën shtetërore në një shtet të së drejtës, në të cilin prona private përbën të drejtë themelore të individit të garantuar shprehimisht nga Kushtetuta, Gjykata konstaton se formulimi i dispozitës së kundërshtuar, por edhe i gjithë titulli që rregullon trashëgiminë me testament, ka mbetur i pandryshuar në përmbajtje edhe në ditët e sotme.

59. Gjykata, pa vënë në diskutim mbrojtjen e veçantë që martesë dhe familja kanë në rendin tonë juridik, konstaton se zhvillimet ekonomike dhe kulturore, si dhe ndryshimet në legjislacion pas hyrjes në fuqi të KC-së, kanë zgjeruar edhe konceptin tradicional të familjes. Ky

koncept gjen gjerësisht trajtim edhe në KF, ku që me miratimin në vitin 2003, përveç bashkëjetesës ligjore (martesa) edhe bashkëjetesa *de facto* mori një vëmendje të re dhe të posaçme nga ligjvënësi, për shkak të nevojës për reflektim të zhvillimeve të reja shoqërore. Kështu, sipas nenit 163, bashkëjetesa përkufizohet si një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie. Në vijim, ligjvënësi parashikon edhe mundësinë e rregullimit të pasojave që rrjedhin nga ky bashkim në lidhje me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës (neni 164).

60. Një evoluim i tillë gjendet edhe në jurisprudencën e gjykatave evropiane, veçanërisht atë të GJEDNJ-së, e cila nuk e kufizon familjen bazuar vetëm në martesë, por edhe në marrëdhëniet *de facto* dhe në kritere të tilla si: bashkëjetesa, kohëzgjatja e një marrëdhënieje dhe angazhimi personal midis partnerëve. Gjithashtu, familja nuk kufizohet vetëm në marrëdhëniet sociale, morale apo kulturore, por edhe në interesat me natyrë materiale dhe detyrimet (*shih vendimin e GJEDNJ-së Pla dhe Puncernau kundër Andorës, 13 korrik 2004, § 26*).

61. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se pavarësisht se KEDNJ-ja nuk vendos një detyrim për shtetet që të njohin një regjim të caktuar të familjes ose kategori të partnerëve për qëllime të trashëgimisë, tendenca e shteteve evropiane është drejt zgjerimit të konceptit të saj. Kështu, legjislacionet e shteteve evropiane, në mënyrë uniforme, kanë parashikuar se e drejta për të disponuar me testament mund të kufizohet vetëm nga rezerva ligjore, e cila ka për qëllim mbrojtjen e interesave të kategorive të caktuara të trashëgimtarëve ligjorë. Kjo kategori përfshin bashkëshortin pasjetues, fëmijët (përfshi edhe ata të adoptuar, të lindur brenda dhe jashtë martesës), nipërit, partnerët e regjistruar ose jo (përfshi edhe ata të të njëjtit seks) ose prindërit, ku secili shtet ka përcaktuar radhën e përparësisë për ta në varësi të kulturës dhe traditës së tij, si dhe duke përcaktuar një kuotë për këto kategori. Për sa i përket masës së kuotës të rezervuar, ajo varion deri në gjysmën e pasurisë (Austria, Gjermania, Greqia, Holanda, Rumania, Çekia, Lituania, Sllovakia, Suedia, Estonia, Malta dhe Finlanda); deri në dy të tretat e pasurisë (Italia, Bullgaria, Spanja dhe Portugalia); deri në tre të katërtat e pasurisë (Belgjika, Franca dhe Luksemburgu). Ndërsa pjesa e mbetur e pasurisë mund të disponohet lirisht nga trashëgimlënësi, lejim i cili gjendet i shprehur ose i nënkuptuar në këto legjislacione.

62. Për sa i takon konceptit të rezervës ligjore, Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë është shprehur se e drejta e fëmijëve të trashëgimtarit për një pjesë të detyruar të pasurisë së tij ka qenë në qendër të debateve, pjesërisht për faktin se rrethanat shoqërore kanë

ndryshuar që nga miratimi i KC-së, po ashtu edhe funksioni social i familjes dhe marrëdhëniet familjare. Në ditët e sotme jetëgjatësia mesatare e njeriut është rritur dhe sistemi i sigurimit social ka zëvendësuar me kalimin e kohës rrjetën sociale që sigurohej nga lidhjet familjare. Veçanërisht fëmijët nuk kontribuojnë në vendosjen e pasurisë së trashëgimlënësit në ditët e sotme. Thjesht lidhja biologjike midis trashëgimtarit dhe fëmijëve të tij nuk e justifikon përfitimin e pasurisë nga këta të fundit. Megjithatë, pavarësisht këtyre konstatimeve, rezerva ligjore ka shërbyer kryesisht për të forcuar lidhjet familjare dhe heqja e saj do të sillte shpërbërjen e familjes dhe cenonte të drejtat e fëmijëve të lindur jashtë martese (*shih vendimin e Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë 1 BvR 1644/00, 1 BvR 188/03, datë 19 prill 2005*).

63. Në analizë të sa më sipër, Gjykata çmon se megjithëse legjislatori gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi në përcaktimin e kufijve të së drejtës së trashëgimisë me testament, ai duhet të marrë masa që rregullimi i saj të mos bëhet në mënyrë arbitrare dhe pa arsye të qenësishme. Në këtë pikë, Gjykata thekson se stabiliteti juridik i vendit shërben si një kusht i rëndësishëm për funksionimin e shtetit të së drejtës, megjithatë ligji duhet të përshtatet me kushtet sociale dhe zhvillimin e shoqërisë. Për këto arsye, transformimi i shpejtë i shoqërisë dhe traditave në vitet e fundit, gjatë të cilave është tejkaluar monopoli i modelit të familjes tradicionale dhe është pranuar lindja e formave të ndryshme familjare, kërkon mbrojtje të veçantë dhe pritshmëri për t'u rregulluar si institute ligjore nga shteti. Me fjalë të tjera, objektivi i ligjvënësit dhe masat e marra për këtë qëllim në kohën e hyrjes në fuqi të KC-së (1994) nuk mund të jenë të njëjta edhe në ditët e sotme.

64. Në këtë kontekst, Gjykata vë në dukje se duke qenë se *de jure* trashëgimia nënkupton kalimin ligjërisht të pronësisë për një pasuri dhe se ndonëse, legjislatori, në mënyrë të arsyeshme, mund të kufizojë disponimin e saj për atë rreth të trashëgimtarëve të cilët kanë një marrëdhënie gjaku, një rregullim i drejtë në përputhje me kushtet e sotme nuk mund të shmangë individë të cilët *de facto* janë anëtarë të familjes. Thënë kjo, legjislatorit i lind detyra të mbrojë thelbin tradicional të institutit të trashëgimisë, duke mos anashkaluar faktin se ligji duhet t'u përshtatet kushteve sociale si një parim thelbësor i shtetit të së drejtës, por edhe të ruajë një balancë të arsyeshme midis kategorive të trashëgimtarëve ligjorë dhe atyre testamentarë. Në këtë këndvështrim, Gjykata thekson se në parim vjetrimi i normës nuk përbën *per se* shkak për antikushtetutshmërinë e saj, përveçse në rastin kur ajo nuk i përgjigjet zhvillimit social, kulturor,

ekonomik dhe moral të shoqërisë në atë masë që nuk respekton thelbin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

65. Bazuar në sa më lart, Gjykata konstaton se ligjvënësi edhe pse e ka përfshirë bashkëshortin/en pasjetues/e në nenin 361 të KC-së si trashëgimtar ligjor të radhës së parë, gjë e cila tregon vendin e veçantë që legjislatori ka parashikuar, në këtë rast, për këtë anëtar të familjes, nuk e ka përfshirë atë në rrethin e trashëgimtarëve testamentarë. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se bashkëshorti pasjetues ka një pozicion të veçantë në marrëdhëniet familjare, jo vetëm për shkak të marrëdhënies së afërt familjare me trashëgimlënësin, por edhe për shkak të kontributit të tij në rritjen dhe garantimin e pasurisë gjatë jetës së përbashkët familjare. Duke mos e parashikuar në kategorinë e trashëgimisë me testament, natyrshëm ekziston mundësia që ai të kthehet në barrë për shoqërinë. Për këtë arsye ai parashikohej si trashëgimtar testamentar në KC-në e vitit 1929, ndërkohë që edhe KF-ja në fuqi ka parashikuar dispozita të veçanta për bashkëshortin (neni 54 – kontributi i bashkëshortëve; neni 57 – pëlqimi i bashkëshortëve; neni 63 – disponimi i të ardhurave; neni 67 - të drejta të pashmangshme; neni 76 – prezumimi i pasurisë së përbashkët; neni 81 dhe nenet 84-86 – detyrimet mbi pasurinë në bashkësi etj.). Prandaj, Gjykata vlerëson se bashkëshorti pasjetues duhet të ketë një vend në rrethin e trashëgimtarëve testamentarë të barabartë me atë të fëmijëve. Për rrjedhojë, pamundësia e disponimit të pasurisë për të me testament është në kundërshtim me qëllimin e legjislatorit për të garantuar dhe siguruar interesin e familjes dhe për këtë shkak, nevoja e parashikimit të tij edhe si trashëgimtar testamentar përbën një mjet të nevojshëm për të siguruar një mbrojtje sa më efektive dhe për të forcuar qëndrueshmërinë e marrëdhënieve familjare edhe pas vdekjes së trashëgimlënësit.

66. Në të njëjtën linjë, Gjykata, në raport edhe me parashikimet legislative evropiane, konstaton se mbrojtja e së drejtës për të disponuar pronën me testament mund të arrihet nëpërmjet parashikimit të një kuote në dispozicion të trashëgimlënësit, të cilën ai mund ta disponojë sipas vullnetit të tij ose në çfarëdolloj forme të cilën ligjvënësi e sheh të përshtatshme. Kjo do të thotë se kufizimi i synuar në lirinë e disponimit me testament mund të arrihet prej ligjvënësit edhe me mjete të tjera më të lehta, të cilat nuk do e kthenin atë në një kufizim absolut. Në këtë këndvështrim, përcaktimi i një pjese të pasurisë, duke i dhënë trashëgimlënësit të drejtën për të disponuar sipas vullnetit të tij, për Gjykatën konsiderohet një qasje e pranueshme dhe e balancueshme edhe në lidhje me interesat e anëtarëve të tjerë të familjes të përfshirë në trashëgiminë me testament.

67. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se dispozita e kundërshtuar, duke mos parashikuar bashkëshortin pasjetues si trashëgimtar testamentar, vendos kufizim për sa i përket rrethit të trashëgimtarëve testamentarë, si dhe nuk garanton disponimin lirisht sipas vullnetit të trashëgimlënësit në asnjë pjesë të pasurisë së tij. Gjykata vlerëson se mungesa e këtyre parashikimeve konsiderohet e padrejtë dhe e bazuar mbi vlerësime alogjike. Kufizimi, edhe pse i përgjigjet interesit publik, nuk është proporcional sipas kriterëve të vendosura nga neni 17 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, dispozita përmban një boshllëk ligjor që sjell pasoja negative për të drejtat e trashëgimlënësit, duke cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën e tij për të disponuar pasurinë *mortis causa*. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i gjykatave referuese për cenimin e së drejtës së pronës të lidhur me parimin e sigurisë juridike është i bazuar.

68. Gjithashtu, Gjykata rithekson domosdoshmërinë që paraqet për funksionimin e shtetit të së drejtës shmangia e boshllëkut ligjor, por edhe funksionin e saj si ligjvënës negativ për garantimin e kushtetutshmërisë, i cili në respektim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk mund të ndërhyjë në kompetencat e ligjbërësit për të normuar rregullimin e drejtë të dispozitave ligjore (*shih vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

69. Për pasojë, Gjykata, bazuar në nenin 76, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, me qëllim që t'i japë ligjvënësit kohën e mjaftueshme për të miratuar rregullat e reja ligjore në përputhje me arsyetimin e këtij vendimi, vlerëson se Kuvendi duhet t'i plotësojë ato brenda një viti nga hyrja në fuqi e tij.

70. Së fundmi, Gjykata evidenton se objekti i shqyrtimit kushtetues është neni 377 i KC-së, dispozitë e cila bën pjesë në Titullin III të Pjesës III të KC-së, që i dedikohet trashëgimisë me testament. Në këtë kuptim, duke respektuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes sipas nenit 48 të ligjit nr. 8577/2000, por edhe me qëllim garantimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të koherencës së rregullave, duke marrë në konsideratë faktin se dispozitat e trashëgimisë përbëjnë një sistem normash të kodifikuara, vëren se në kuadër të ndryshimeve shoqërore dhe institucionale i përket ligjvënësit të rishikojë, me frymën e Kushtetutës dhe në respekt të parimit të barazisë para ligjit, të mosdiskriminimit dhe së drejtës familjare, por edhe në linjë me parashikimet e KF-së dhe me analizën e këtij vendimi, të gjithë titullin që parashikon dispozitat që lidhen me institutin e trashëgimisë me testament në KC. Në këtë kuptim, nevojitet rishikimi edhe në aspekte të tjera, por pa u kufizuar vetëm në to, të tilla si bashkëjetesa dhe rezerva ligjore.

Për sa i takon kësaj të fundit, e drejta e trashëgimtarëve të mitur, që trashëgojnë me zëvendësim pa kufizim në vijë të drejtë, si dhe statusi i personit të paaftë për punë nevojitet të përshtaten me zhvillimet e kohës e në veçanti me ndryshimet legislative në fushën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të lidhura me kohën e daljes në pension ose invaliditetin.

71. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesat e gjykatave referuese sipas arsytimit të mësipërm janë të bazuara, ndaj duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 377 të Kodit Civil, për shkak të boshllëkut ligjor sipas arsytimit të këtij vendimi.
3. Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë të plotësojë boshllëkun ligjor brenda një viti nga hyrja në fuqi e vendimit.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 27.12.2023

Shpallur më 31.01.2024

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuese Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me objekt: “*Shfuqizimi i nenit 377 të Kodit Civil, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, ndonëse bashkohem me shumicën për konstatimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 377 të Kodit Civil (KC), për shkak të boshllëkut ligjor, çmoj se Gjykata duhej të kishte vendosur shfuqizimin e këtij neni, si dhe të kishte trajtuar edhe problemet e antikushtetutshmërisë që paraqesin dispozita të tjera të KC-së të lidhura me të. Në vijim po paraqes argumentet lidhur me qëndrimin tim.

2. Gjykatat referuese i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e nenit 377 të KC-së, i cili parashikon se trashëgimlënësi që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë në favor të çdo personi fizik ose juridik. Shumica në vendimin e saj ka trajtuar pretendimet e kërkueseve në drejtim të së drejtës së pronës të lidhur me parimin e sigurisë juridike, duke analizuar kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Ajo duke arsyetuar se dispozita e kundërshtuar përbën kufizim në të drejtën e trashëgimlënësit për të disponuar pronën e tij lirisht pas vdekjes, jo vetëm te personat jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë, por edhe brenda këtyre të fundit, ka çmuar se dispozita cenon kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes. Shumica ka vlerësuar se ligjvënësi nuk e ka parashikuar bashkëshortin në rrethin e trashëgimtarëve testamentarë, pavarësisht se ai ka pozicion të veçantë në marrëdhëniet familjare. Gjithashtu, ajo ka argumentuar edhe se mbrojtja e së drejtës për të disponuar pronën me testament mund të arrihet nëpërmjet parashikimit të një kuote në dispozicion të trashëgimlënësit, të cilën mund ta disponojë sipas vullnetit të tij ose në çfarëdo forme që ligjvënësi e sheh të përshtatshme. Për rrjedhojë, ligjvënësi i është lënë detyra të plotësojë boshllëkun e konstatuar, si dhe të rishikojë të gjithë kreun që parashikon dispozitat që lidhen me institutin e trashëgimisë testamentare në KC edhe në lidhje me aspekte të tjera, por pa u kufizuar vetëm në to, të tilla, si, bashkëjetesa dhe rezerva ligjore (*shih paragrafët 41, 65, 66 dhe 70 të vendimit*).

3. Për sa u përket argumenteve të antikushtetutshmërisë së nenit 377 të KC-së, bashkohem me shumicën, ndonëse jam e mendimit se Gjykata duhej të vendoste shfuqizimin e kësaj dispozite. Ndërsa në ndryshim nga shumica, mendoj se megjithëse objekti i kërkesës së paraqitur nga gjykatat referuese është papajtueshmëria me Kushtetutën e nenit 377 të KC-së,

Gjykata, në ushtrim të kompetencave të saj, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr.8577/2000, duhej të ishte shprehur edhe për nenet 371 dhe 379 të KC-së.

4. Për të vlerësuar ndërlidhjen midis këtyre dispozitave, sjell në vëmendje se neni 379 i KC-së ka parashikuar rezervën ligjore duke kufizuar trashëgimlënësin i cili në momentin kur disponon pasurinë me testament, nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, paragrafi i dytë i KC-së), si dhe trashëgimtarët e tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveçse kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar.

5. Nga përmbajtja dhe analiza e këtyre dispozitave rezulton se e drejta e trashëgimlënësit për të disponuar pasurinë e tij është e kufizuar dy herë, së pari, nëpërmjet rezervës ligjore dhe së dyti, edhe midis tri radhëve të para të trashëgimisë ligjore. Vetëm në rast të mungesës së këtyre të fundit dhe pasi ka plotësuar kërkesën për rezervën ligjore, trashëgimlënësi mund të disponojë pasurinë e tij te persona të tjerë, jashtë rrethit familjar. Këto parashikime ligjore, në mendimin tim, cenojnë në thelb të drejtën e individit për të disponuar pasurinë lirisht pas vdekjes, duke e kthyer atë praktikisht të pazbatueshme dhe iluzore.

6. Ashtu siç ka përmendur edhe shumica, rezerva ligjore është një institut i njohur pothuajse në të gjitha legjislacionet evropiane. Funkzioni i saj është të mbrojë dhe garantojë lidhjet familjare në aspektin moral e material edhe pas vdekjes së trashëgimlënësit. Nuk mund të konceptohet eliminimi i saj nga legjislacioni, pasi kjo do të passillte shkatërrimin e mëtejshëm të institutit të familjes.

7. Megjithatë, nëse do të kthehemi te parashikimi që ligjvënësi shqiptar i ka bërë rezervës ligjore në nenin 379 të KC-së, konstatohet se ai ka parashikuar një radhë të gjatë të trashëgimtarëve. Kjo, pasi rezerva ligjore referon në nenin 361 të KC-së e cila parashikon trashëgiminë ligjore, ku në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Vetëm në rast se në radhë të parë nuk ka trashëgimtarë të tjerë, përveç bashkëshortit, thirren në trashëgim trashëgimtarë të radhës së dytë dhe kur nuk ka as të tillë, ata të radhës së tretë. Kufizimi shkon më tej në rastin kur trashëgimlënësi nuk ka lënë bashkëshort pasjetues, trashëgimia ligjore parashikohet deri në radhën e gjashtë. Për rrjedhojë, ndonëse testamenti paraqitet si një akt i cili pasqyron vullnetin e lirë të trashëgimlënësit për të përcaktuar fatin e pasurisë së tij pas vdekjes, në realitet,

kufizimet që ka parashikuar ligjvënësi në nenin 379 të KC-së janë të shumëfishta, të detyrueshme, të njëpasnjëshme dhe mjaft të zgjeruara, duke e cenuar këtë të drejtë në praktikë deri në asgjësimin e saj.

8. Për më tepër, neni 371 i KC-së ka parashikuar konceptin e trashëgimitarit të paaftë për punë, si personi që nuk ka mbushur moshën 16 vjeç ose 18 vjeç kur vazhdon mësimet, burrat që kanë mbushur moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç, si dhe pavarësisht nga mosha, ata që janë invalidë të grupit të parë dhe të grupit të dytë (neni 371).

9. Për sa i përket kësaj dispozite, nuk mund të mos evidentohet se në këtë kategori, përveç të tjerëve, përfshihen edhe *“burrat që kanë mbushur moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç”*. Nga një lexim përmbajtësor i dispozitës kuptojmë se kriteri i përdorur në këtë rast është mosha e trashëgimitarit, përmbushja e së cilës, në mendimin tim, nuk mund të përfshihet *apriori* në kategorinë e personave të paaftë për punë. Është e pranueshme se qëllimi fillestar i ligjvënësit në draftimin e kësaj dispozite i përket një periudhe kohore kur aftësia për të punuar dhe masa e pensionit të përfitohej ishte relativisht e ulët. Megjithatë, në ditët e sotme ky parashikim mund të konsiderohet i vjetruar, duke mbajtur parasysh se ndryshimet legjislative të lidhura me kohën e daljes në pension ose invaliditetin e kanë ulur në mënyrë të dukshme qëllimin dhe përdorimin e normës. Për më tepër, pensioni mund të konsiderohet një mjet jetese dhe nuk janë të pakta rastet kur trashëgimtari, megjithëse ka mbushur moshën e pensionit, është i punësuar dhe i aftë për të siguruar të ardhura të mjaftueshme, në mënyrë të pavarur nga pritshmëritë e tij për të përfituar pasuri me anë të trashëgimisë. Gjithashtu, vlen të përmendet edhe fakti se ligjvënësi në periudha të ndryshme kohore e ka rritur moshën e daljes në pension për burrat dhe gratë në përputhje me situatat makroekonomike, demografike, nivelin e punësimit, të pagave dhe zhvillimin e tregut të punës.

10. Për sa më lart, vlerësoj se radha e gjatë e trashëgimitarëve ligjorë, të parashikuar në nenin 379 të KC-së, përfshirja e trashëgimitarëve të paaftë për punë në konceptin e rezervës ligjore, pavarësisht faktit nëse janë ose jo praktikisht të aftë për punë, si dhe detyrimi i trashëgimitarit për të disponuar vetëm midis tri radhëve të para të trashëgimisë ligjore, përbën një asgjësim total të së drejtës për të disponuar me testament, duke i hequr këtij të fundit edhe karakterin humanitar. Në këtë mënyrë, trashëgimia testamentare është bërë e pazbatueshme në praktikë dhe ky kufizim nuk justifikohet me interesin publik që synon të mbrojë dispozita për mbrojtjen e individëve që nuk kanë mjete jetese. Ky interes publik nuk mund të justifikojë

ekzistencën e kufizimit, kur personat që trashëgojnë kanë ose gëzojnë mjetet e nevojshme të jetesës dhe mund ta përballojnë jetesën, po kështu edhe ata që vijnë me zëvendësim. Kufizimi nuk i përgjigjet as kriterit tjetër të përcaktuar në nenin 17 të Kushtetutës, proporcionalitetit të ndërhyrjes, pasi kufizimi i së drejtës për të disponuar pasurinë është absolut dhe nuk i lë hapësirë trashëgimtarit për të shprehur lirisht vullnetin e tij. Në analizë të këtyre argumenteve, vlerësoj se Gjykata duhej të shfuqizonte edhe nenin 379 të KC-së për pjesën që referon në radhën e gjatë të trashëgimtarëve ligjorë të përmendur në nenin 361, si dhe për sa i përket konceptit të “trashëgimtarit të paaftë për punë”, sipas përcaktimit të nenit 371 të KC-së “burrat që kanë mbushur moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç”.

11. Në përfundim, nisur nga fakti se disponimi i nenit 377 i ndërlidhur me nenet 371 dhe 379 të KC-së kanë kufizuar në mënyrë absolute të drejtën e trashëgimtarit për të disponuar pasurinë sipas vullnetit të tij, vlerësoj se Gjykata duhej të vendoste shfuqizimin e tyre, duke lënë detyra konkrete për ligjvënësin në përputhje me zhvillimet e kohës.

Anëtare: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 9 (Gj) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket kërkesave të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me objekt: “*Shfuqizimi i nenit 377 të Kodit Civil, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket zgjidhjes së kësaj çështjeje, pasi vlerësojmë se duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesave.

2. Për sa u përket këtyre kërkesave, në çështjen e paraqitur nga Gjykata e Lartë, procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga shtetasja H.S., trashëgimtare e vetme ligjore e shtetases Z.I. (trashëgimlënësja), e cila, në tetor 1993, me akt noterial, ka disponuar të gjithë pasurinë e saj me testament, duke caktuar si trashëgimtar testamentar J.I., që është nipi i bashkëshortit të saj të paravdekur (në vitin 1981), ndërsa ka përjashtuar nga trashëgimia çdo trashëgimtar ligjor. Trashëgimia është çelur në kohën e vdekjes së testatores Z.I., në datën 24.10.1996, ndërsa kalimi i testamentit në regjistrin e përgjithshëm të akteve noteriale është bërë nga noteri në datën 07.03.2007, duke lëshuar më pas gjykata dëshminë e trashëgimisë testamentare. Në korrik 2007 trashëgimtarja ligjore H.S. i është drejtuar gjykatës me padi për kërkimin e trashëgimit sipas nenit 349 të Kodit Civil (KC) përkundrejt trashëgimtarit testamentar J.I., duke kërkuar detyrimin e këtij të fundit ta njohë atë si trashëgimtare të Z.I. dhe t’i dorëzojë pasurinë e paluajtshme trashëgimore të llojit “apartament”, të ndodhur në qytetin e Vlorës, me pretendimin se testamenti është veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, pasi është kryer në kundërshtim me ligjin civil të kohës, ashtu edhe me kërkesat e legjislationit të kohës për noterinë. Nga ana tjetër, i padituri J.I. ka paraqitur kundërpadi, duke kërkuar detyrimin e paditëses për ta njohur pronar me parashkrim fitues me titull për pasurinë e paluajtshme objekt gjykimi sipas nenit 168 të KC-së. Për sa i përket çështjes së paraqitur nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga ish-bashkëshortja e trashëgimlënësit P.S., i cili, me testamentin me akt noterial, hartuar në dhjetor 2017, ka disponuar të drejtat e tij të pronësisë për disa pasuri të veçanta të tij, duke përcaktuar për një pjesë të tyre si trashëgimtar testamentar djalin e mitur dhe për një nga ato bashkëjetuesen e tij. Fëmija i mitur i trashëgimlënësit, përmes nënës si përfaqësuese ligjore (ish-bashkëshortes së trashëgimlënësit), ka paraqitur padi me objekt pavlefshmërinë absolute të testamentit për pjesën që ka disponuar në favor të bashkëjetueses E.Ç. dhe detyrimin e kësaj të fundit për ta njohur si trashëgimtar të vetëm të trashëgimlënësit P.S.

3. Bazuar në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë pezulluar gjykimin e çështjeve përkatëse, duke dërguar për shqyrtim në Gjykatë çështjen e kushtetutshmërisë së nenit 377 të KC-së, respektivisht për sa kjo dispozitë në mënyrë të nënkuptuar ndalon disponimin me testament të pasurisë në favor të çdo personi të tretë kur trashëgimlënësi ka lënë të paslindur ose të paralindur ose vëllezër apo motra, si dhe për sa ajo nuk parashikon bashkëjetuesin në rrethin e këtyre të fundit (të paslindurve, të paralindurve, vëllezërve dhe motrave). Në lidhje me këtë dispozitë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ajo cenon të drejtën e pronës private, që përcakton posedimin, gëzimin dhe disponimin si tre tagrat kryesore të pronarit, ku një nga mënyrat e disponimit është nëpërmjet testamentit, si dhe nenin 17 të Kushtetutës, pasi nuk respekton kriterin e interesit publik dhe kriterin e proporcionalitetit, duke kufizuar në mënyrë absolute lirinë testamentare, ndërsa sipas Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, krahas së drejtës së pronës private, ajo cenon edhe të drejtën për respektimin e jetës familjare, parimin e barazisë përpara ligjit, si dhe parimin e sigurisë juridike, në këndvështrim të qartësisë, kuptueshmërisë dhe koherencës së sistemit normativ.

4. Për sa u përket pretendimeve të ngritura, shumica ka vlerësuar se argumentet e dhëna nga gjykatat referuese, konkretisht se ndalimi i disponimit me testament të pasurisë në favor të një personi të tretë, për aq kohë sa trashëgimlënësi ka lënë trashëgimtarë ligjorë, kufizon të drejtat dhe liritë e tij themelore dhe njëkohësisht ndikon në çekuilibrimin e marrëdhënieve familjare dhe shoqërore, si dhe se për shkak të paqartësisë, mungesës së kuptueshmërisë, por dhe përshtatjes me zhvillimet e institucionit të familjes, dispozita e kundërshtuar cenon të drejtat kushtetuese të trashëgimlënësit, të garantuara nga nenet 4, 18 dhe 53 të Kushtetutës, janë të mjaftueshme për legjitimimin e tyre për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, për rrjedhojë, përkundër pretendimit të subjektit të interesuar, gjykatat referuese e kanë përmbushur kriterin e parashtrimit të arsyeve bindëse për antikushtetutshmërinë e normës, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës (*shih paragrafët 25-26 të këtij vendimi*). Po sipas shumicës, ndonëse të dyja gjykatat kanë bërë përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjet objekt gjykimi, sërish kjo ka qenë e pamundur për shkak të përcaktimit shterues të dispozitës së kundërshtuar, për rrjedhojë kanë plotësuar edhe kriterin tjetër të legjitimitit, atë të përpjekjes për ta interpretuar normën në përputhje me Kushtetutën (*shih paragrafin 29 të këtij vendimi*).

5. Po kështu, në lidhje me themelin e pretendimeve, shumica ka vlerësuar se dispozita e kundërshtuar plotëson kriterin e ndërhyrjes me ligj të ligjvënësit në kufizimin e së drejtës së pronës, si dhe kriterin e interesit publik, pasi kufizimet e kësaj të drejte në drejtim të lirisë së disponimit me testament janë vendosur për të mbrojtur, brenda marrëdhënieve familjare, të drejtat e një rrethi të caktuar të trashëgimtarëve ligjorë, për shkak të mbrojtjes së veçantë që neni 53 i Kushtetutës i ka garantuar familjes, qëndrueshmëria e së cilës përbën njësinë bazë të organizimit shoqëror të vendit (*shih paragrafët 42, 50 dhe 51 të këtij vendimi*).

6. Ndërsa në lidhje me kriterin e proporcionalitetit, shumica ka vlerësuar se dispozita e kundërshtuar, e lexuar së bashku me nenin 379 të KC-së, passjell kufizimin e disponimit të pasurisë me testament në dy mënyra: i) testamenti nuk duhet të cenojë rezervën ligjore; ii) testatori mund të disponojë në favor të cilitdo prej trashëgimtarëve ligjorë, por vetëm brenda tri radhëve të para të trashëgimisë ligjore dhe, në rastin e kufizimit të dytë, vetëm nëse mungojnë trashëgimtarët e tri radhëve të para, trashëgimlënësi mund t'ia lërë me testament pasurinë e tij kujtdo prej trashëgimtarëve të radhëve të tjera, e po kështu edhe jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë (*shih paragrafin 56 të këtij vendimi*).

7. Në vijim, duke theksuar funksionin e Gjykatës si ligjvënës negativ për garantimin e kushtetutshmërisë, shumica ka vlerësuar edhe se: megjithëse legjislatori gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi në përcaktimin e rrethit të trashëgimtarëve, ai nuk mund të parashikojë norma ligjore për trashëgiminë testamentare në mënyrë arbitrare dhe pa arsye të qenësishme [...]; objektivi i ligjvënësit dhe masat e marra për këtë qëllim në kohën e hyrjes në fuqi të KC-së (1994) nuk mund të jenë të njëjta edhe në ditët e sotme [...]; në parim vjetrimi i normës nuk përbën *per se* shkak për antikushtetutshmërinë e saj, përveçse në rastin kur ajo nuk i përgjigjet zhvillimit social, kulturor, ekonomik dhe moral të shoqërisë në atë masë që nuk respekton thelbin e të drejtave dhe lirive të njeriut [...]; legjislatori, ndonëse në mënyrë të arsyeshme mund të kufizojë disponimin e saj (pasurisë) për atë rreth të trashëgimtarëve të cilët kanë një marrëdhënie gjaku, një rregullim i drejtë në përputhje me kushtet e sotme nuk mund të shmangë individë të cilët *de facto* janë anëtarë të familjes [...]; dispozita e kundërshtuar, duke mos parashikuar bashkëshortin pasjetues si trashëgimtar testamentar, vendos kufizim për sa i përket rrethit të trashëgimtarëve testamentarë, si dhe nuk garanton disponimin lirisht sipas vullnetit të trashëgimlënësit në asnjë pjesë të pasurisë së tij, ndërkohë që mungesa e këtyre parashikimeve përbën një masë të padrejtë dhe të bazuar mbi vlerësime alogjike [...]; dispozita e kundërshtuar

përmban një boshllëk ligjor që sjell pasoja negative për të drejtat e trashëgimlënësit, duke cenuar në mënyrë joproportionale të drejtën e tij për të disponuar pasurinë *mortis causa* [...]; bashkëshorti pasjetues duhet të ketë një vend në rrethin e trashëgimtarëve testamentarë të barabartë me atë të fëmijëve, ndaj pamundësia e disponimit të pasurisë për të me testament është në kundërshtim me qëllimin e legjislatorit për të garantuar dhe siguruar interesin e familjes dhe, për këtë shkak, nevoja e parashikimit të tij edhe si trashëgimtar testamentar përbën një mjet të nevojshëm për të siguruar një mbrojtje sa më efektive dhe për të forcuar qëndrueshmërinë e marrëdhënieve familjare edhe pas vdekjes së trashëgimlënësit [...]; kufizimi i synuar në lirinë e disponimit me testament mund të arrihet prej ligjvënësit edhe me mjete të tjera më të lehta, të cilat nuk do ta kthenin atë në një kufizim absolut, ku përcaktimi i një kuote/pjesë të pasurisë, duke i dhënë trashëgimlënësit të drejtën për të disponuar sipas vullnetit të tij për të, konsiderohet një qasje e pranueshme dhe e balancueshme edhe në lidhje me interesat e anëtarëve e tjerë të familjes të përfshirë në trashëgiminë testamentare [...] (*shih paragrafët 63-68 të këtij vendimi*). Po kështu, shumica është shprehur se, me qëllim garantimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të koherencës së rregullave, duke marrë në konsideratë faktin se dispozitat e trashëgimisë përbëjnë një sistem normash të kodifikuara, në kuadër të ndryshimeve shoqërore dhe institucionale, i përket ligjvënësit të rishikojë, me frymën e Kushtetutës dhe në respekt të parimit të barazisë përpara ligjit, të mosdiskriminimit dhe së drejtës familjare, por edhe në linjë me parashikimet e Kodit të Familjes dhe me analizën e këtij vendimi, të gjithë Titullin III të Pjesës III të KC-së, që parashikon dispozitat që lidhen me institutin e trashëgimisë me testament, në veçanti, por pa u kufizuar vetëm në to, për sa i përket bashkëjetesës dhe rezervës ligjore, sa u takon të miturve që trashëgojnë me zëvendësim pa kufizim në vijë të drejtë, si dhe statusit të personit të paaftë për punë, që duhet të përshtaten me zhvillimet e kohës e në veçanti me ndryshimet legjislative në fushën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të lidhura me kohën e daljes në pension ose invaliditetin (*shih paragrafin 70 të këtij vendimi*).

8. Për sa më lart, në rastin konkret, sipas shumicës, neni 377 i KC-së përmban boshllëk ligjor në pjesën që nuk parashikon si trashëgimtar testamentar bashkëshortin dhe bashkëjetuesin, si dhe në lidhje me lirinë e trashëgimlënësit për të disponuar me testament në favor të çdo personi të tretë të një pjese të pasurisë, në formën e një kuote.

9. Në lidhje me këtë qëndrim të shumicës, nuk jemi dakord me argumentet që do të paraqesim si më poshtë.

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se për të shmangur çdo mundësi për ndërhyrje në kompetencat e pushtetit ligjvënës, ajo nuk merr përsipër të kryejë rolin e legjislatorit, por synon t'u japë jetë normave kushtetuese përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre (*shih vendimet nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, nuk është detyrë e saj të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullime ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimet nr. 12, datë 14.04.2010; nr.16, datë 25.07.2008; nr. 75, datë 19.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në vlerësimin tonë, që të merret në shqyrtim nga Gjykata, boshllëku ligjor që përmban një dispozitë e kundërshtuar si antikushtetuese duhet të jetë i tillë që dukshëm cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese të individit. Në këtë kuptim, vetëm një boshllëk që nuk është i mundur të riparohet, qoftë përmes interpretimit gjyqësor, qoftë normave të tjera ligjore dhe që haptazi cenon të drejtat themelore është i tillë që i nënshtrohet juridiksionit kushtetues. Në rastin konkret, krahas faktit se gjatë gjykimit kushtetues të çështjeve nuk u arrit të provohej cenimi i të drejtave dhe lirive themelore, si rrjedhojë e boshllëkut të pretenduar, vlerësojmë se duke marrë në shqyrtim dispozitën e kundërshtuar, Gjykata ka marrë rolin e legjislatorit pozitiv, çka nuk është detyrë dhe funksion i saj.

12. Në këtë drejtim, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se autonomia e interpretimit të saj nuk është e pakufizuar, por ndalet përpara interpretimit konstant jurisprudencial të gjykatave të zakonshme, pasi edhe në autonominë e saj të plotë të gjykimit Gjykata nuk mund të mos ketë parasysh një interpretim të tillë që i njeh normës legjislative vlerën e saj efektive në jetën juridike, duke qenë se normat janë jo ato që propozohen në mënyrë abstrakte, por ato që zbatohen në punën e përditshme të gjyqtarit që synon t'i bëjë konkrete dhe efikase. Gjykata i është referuar konceptit të së “drejtës së gjallë”, e kuptuar përgjithësisht në sensin e ekzistencës së një “jurisprudence konstante”, “të konsoliduar” mbi një dispozitë të caktuar ligjore (duke pasur pra parasysh mënyrën se si ajo “jeton” në realitetin konkret). Sipas Gjykatës, përdorimi i formulës së “të drejtës së gjallë” e ndihmon atë të përcaktojë raportet me gjyqtarët e zakonshëm në terrenin e interpretimit të së drejtës (e njohur si detyrë që u takon posaçërisht këtyre të fundit), duke marrë në lidhje me këtë një qëndrim vetëkufizues në kuptimin që, nëse një e drejtë e tillë e gjallë ekziston, Gjykata e mban parasysh dhe (me disa përjashtime)

nuk ndalet të bëjë një interpretim të ndryshëm, edhe atje ku i duket asaj më bindëse (*shih vendimin nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Po sipas Gjykatës, ligji nuk duhet të jetë shterues dhe i ngurtë, por duhet t'u lërë hapësirë interpretimi organeve (administrative dhe gjyqësore), në varësi të rrethanave konkrete dhe zhvillimit të normave në kontekst të praktikës (*shih vendimin nr.20, datë 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, u takon autoriteteve gjyqësore (konkretisht, gjykatave të zakonshme) që, përmes interpretimit pajtues, të sjellin qartësi në zbatimin në praktikë të ligjit, në përputhje me standardet më të mira kushtetuese dhe ndërkombëtare.

14. Në rastin konkret, për antikushtetutshmërinë e pretenduar të normës, gjykatat referuese kanë parashtruar mungesën në përmbajtje të saj të parashikimeve konkrete për disponimin e pasurisë nga testatori edhe në favor të bashkëshortit ose bashkëjetuesit. Në ndryshim nga shumica vlerësojmë se, për sa i përket bashkëshortit si subjekt juridik, sikundër rezultoi edhe nga gjykimi kushtetues e u pranua nga palët gjatë gjykimit, situata e tij nuk rezulton në pasiguri juridike, pasi ndonëse neni 377 i KC-së nuk e përcakton shprehimisht këtë subjekt, çështja është zgjidhur tashmë në praktikë përmes interpretimit të dispozitës ligjore të kundërshtuar në jurisprudencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se përmbajtja e nenit 377 të KC-së ka mbetur e pandryshuar që në kohën e miratimit të këtij kodi me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” dhe zbatohet nga gjykata e zakonshme prej rreth 30 vjetësh. Në këtë kuptim, nëse përmbajtja e kësaj dispozite do të kishte shfaqur probleme të pakapërcyeshme gjatë zbatimit në praktikë, kjo do të kishte çuar në rregullimin e saj përmes vendimeve unifikuuese, çka nuk rezulton të jetë bërë në rastin konkret. Mosrregullimi i situatës me instrumente që Gjykata e Lartë i disponon, nuk e ngre këtë çështje në nivel pasigurie juridike të tillë që të konstatohet boshllëku ligjor në nenin 377 të KC-së.

15. Nga ana tjetër, për sa u përket pretendimeve të gjykatave referuese se dispozita e kundërshtuar ometon edhe në lidhje me rregullimin e situatës ligjore të bashkëjetuesit, në qëndrimin e saj shumica, ndërsa arsyeton se “*kufizimet e së drejtës së pronës në drejtim të lirisë së disponimit me testament janë vendosur për të mbrojtur brenda marrëdhënieve familjare të drejtat e një rrethi të caktuar të trashëgimtarëve ligjorë, për shkak të mbrojtjes së veçantë që neni 53 i Kushtetutës i ka garantuar familjes, qëndrueshmëria e së cilës përbën njësinë bazë të organizimit shoqëror të vendit*” dhe se “*duke përcaktuar mënyrën e disponimit të pasurisë pas vdekjes, dispozita synon të mbrojë rrethin e ngushtë familjar dhe ka për qëllim garantimin e*

rendit juridik dhe stabilitetin e marrëdhënieve juridike në shoqëri”, për të mbështetur vendimmarrjen e saj i referohet Kodit të Familjes (KF), duke arsyetuar se “zhvillimet ekonomike dhe kulturore, si dhe ndryshimet në legjislacion pas hyrjes në fuqi të KC-së kanë zgjeruar konceptin tradicional të familjes, duke përfshirë krahas bashkëjetesës ligjore (martesa) edhe bashkëjetesën de facto” (shih paragrafët 50 dhe 59 të këtij vendimi).

16. Në vlerësimin tonë si gjyqtarë në pakicë, referimi që shumica bën në KF për të mbështetur argumentet e saj në drejtim të përfshirjes së bashkëjetuesit në nenin 377 të KC-së, shkon në kundërshtim me qëllimin e ligjvënësit, si hartues i përmbajtjes së normës ligjore, si dhe ndërhyrës, në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese, në hapësirën e veprimtarisë së tij normuese, duke i përcaktuar atij (ligjvënësit) qëllimin që duhet të synojë të arrijë në ndryshimet që do t'i bëjë përmbajtjes së dispozitës ligjore, sipas qëndrimit të mbajtur nga Gjykata përmes këtij vendimi. Shumica nuk mund të arrijë në konkluzione mbi nevojën e rregullimit të përfshirjes së bashkëjetuesit, pa pasur të dhëna, studime dhe analiza shkencore në lidhje me konsiderimin shoqërisht të justifikueshëm të fitimit pa shpërblim të të mirave materiale të të tjerëve, pa të cilat është e pamundur të arrihet në përfundimin se një gjë e tillë përfaqëson moralin, kërkesat e sotme të shoqërisë, vetëm të cilat mund të justifikojnë nevojën për ndërhyrje në ligj.

17. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se qëllimi dhe të drejtat që synojnë të mbrojnë KC-ja dhe KF-ja janë të ndryshme. Kështu, ndërsa qëllimi i KC-së është rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve juridike civile, me qëllim garantimin e stabilitetit dhe sigurisë në marrëdhëniet ligjore ndërmjet subjekteve të së drejtës, KF-ja synon të mbrojë familjen dhe dinamikat familjare, duke rregulluar problematikat që mund të lindin në këtë kontekst. Në këtë kuptim, fakti që e drejta familjare lejon forma të ndryshme të bashkëjetesës nuk mund të kuptohet se u jep këtyre formave edhe të drejta juridike civile, të tilla si ajo e trashëgimisë me testament, që rregullohen nga KC-ja, pasi një interpretim i tillë do të binte në kundërshtim me funksionin e ligjvënësit si hartues i normës. Vlen të përmendet se bashkëjetesa faktike dhe familja faktike, pra jo familja e krijuar nga martesa, nuk janë kuptime identike. Në këtë kontekst, çmujmë se rregullimi që ligjvënësi i ka bërë nenit 377 të KC-së, për sa i përket disponimit të pasurisë me testament, është kompetencë e ligjvënësit, i cili ka për detyrë të normojë rregullin e përgjithshëm të sjelljes së individit në përputhje me kërkesat dhe zhvillimet e shoqërisë shqiptare, dhe më pas norma juridike mund t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues.

18. Në vështrim të analizës së mësipërme, çojmë se përmbajtja e nenit 377 të KC-së përbën çështje të politikës legjislative, pasi i përket ligjvënësit që, brenda hapësirës së tij normuese, të veprojë për rregullimin e kësaj dispozite nëse vlerëson se qëllimi që synon të arrijë përmes ndryshimit të saj përputhet me vlerat, moralin dhe kërkesat e shoqërisë së sotme shqiptare.

19. Nga ana tjetër, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar, gjithashtu, fuqia detyruese dhe zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës, të garantuara nga nenet 132 dhe 145 të Kushtetutës. Sipas Gjykatës, ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të saj është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj, arsytim i cili ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i Gjykatës për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Efekti detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 17, datë 30.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, vlerësojmë se ndryshimi i një parimi të së drejtës trashëgimore, i konsoliduar ndër vite, mund të sjellë si pasojë krijimin e një gjendjeje pasigurie dhe mungese stabiliteti në marrëdhëniet e trashëgimore për subjektet ndaj të cilave zbatohen dispozitat për trashëgiminë me testament, të përcaktuara nga Kreu II, Pjesa III, Titulli III, i KC-së, duke sjellë efekte jo vetëm në çështjet që janë për gjykim aktualisht pranë gjyqësorit të zakonshëm, por edhe në marrëdhëniet juridike të trashëgimisë që do të lindin në vijim. Prandaj, edhe në këtë këndvështrim, çojmë se shumica duhej të tregohet e vetëpërmbajtur, duke vendosur rrëzimin e kërkesave të gjykatave referuese dhe duke evidentuar në vendim të gjitha problematikat që, sipas saj, paraqet dispozita e kundërshtuar si antikushtetuese, duke orientuar ligjvënësin në drejtim të plotësimit të normave ligjore, konkretisht në drejtim të së drejtës së testatorit për disponim më të zgjeruar të pasurisë së tij, gjithsesi sipas modelit legjislativ të zgjedhur prej ligjvënësit.

21. Nga ana tjetër mendojmë se ka një kuptim jo të saktë nga ana e shumicës në lidhje me interpretimin e nenit 377 të lidhur me nenin 379 të KC-së. Sipas asaj, parashikimet e këtyre dispozitave, të lexuara së bashku, passjellin kufizimin gati absolut të së drejtës së disponimit të pasurisë me testament, duke cenuar kështu të drejtën e pronësisë së trashëgimlënësit. Duhet përmendur se testamenti është shprehje e së drejtës së disponimit të sendeve, e drejtë kjo që është

pjesë e së drejtës së pronësisë. Përmes testamentit trashëgimlënësi ka lirinë për të disponuar të gjithë ose një pjesë të pasurisë trashëgimore (pronësinë mbi të mirat materiale, të drejtat reale për sendet e të tjerëve, garancitë reale, kreditë, detyrimet dhe kontratat). Neni 377 i KC-së rregullon caktimin e trashëgimtarit testamentar, ku si i tillë, me radhë përparësie, testatori ka lirinë për të caktuar një ose disa persona në lidhje specifike farefisnore me të (i paslindur, i paralindur, vëlla ose motër) dhe, kur nuk ka të tillë, çdo person tjetër (fizik ose juridik) pa përjashtim, mjafton të ketë zotësinë për të trashëguar me testament. Duhet përmendur se përfshirja në rrethin e personave që kanë përparësi për t'u caktuar si trashëgimtar testamentar, pra të personave për të cilët konsiderohet se kanë një justifikim shoqëror për të fituar me testament, nuk të bën patjetër të tillë, sa kohë një gjë e tillë është në lirinë e disponimit të testatorit. Nga ana tjetër, neni 379 i KC-së rregullon rezervën ligjore, e cila nuk është gjë tjetër veçse kufiri i trashëgimisë testamentare, që nuk mund të dëmtojë të drejtat e trashëgimisë së trashëgimtarëve të ligjshëm të përcaktuar shprehimisht nga norma, konkretisht të fëmijëve të mitur të trashëgimlënësit ose trashëgimtarëve të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim sipas nenit 361, paragrafi i dytë, të KC-së, si dhe trashëgimtarëve të tij të tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim sipas neneve 363 ose 364 të KC-së. Rezerva ligjore përfaqëson të drejtën e këtyre trashëgimtarëve ligjorë brenda një pjese (kuote, fraksioni aritmetik) të caktuar të pasurisë trashëgimore, pjesë/kuotë e cila është e barabartë me pjesën takuese që u vjen sipas trashëgimisë ligjore. Pikërisht vetëm fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarët e tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim dhe, kur është rasti që thirren në trashëgim, trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë, testatori nuk mund t'i përjashtojë nga trashëgimia dhe as të cenojë pjesën e tyre, përndryshe testamenti është i pavlefshëm sipas nenit 407 të KC-së. Thënë sa më lart, ndryshe nga sa shumica ka pranuar, nuk mund të thuhet se liria e testatorit për të disponuar me testament, për shkak të përmbajtjes së nenit 377 të KC-së, e parë veçmas, por edhe të lidhur me përmbajtjen e nenit 379 të tij, kufizohet në një masë të tillë sa të çojë në shuarjen e thelbit të së drejtës. Proporcionaliteti i kufizimit të së drejtës në këtë rast mund të jetë objekt rishikimi nga legjislatori bazuar në zhvillimet ekonomike, sociale, ligjore, traditën dhe moralin aktual të shoqërisë, por çdo ndryshim në ligj i përket së ardhmes, ndërkohë që një argument i tillë i përdorur nga shumica nuk mund të shërbejë për të konstatuar boshllëk ligjor për të tashmen dhe, aq më pak, për të kaluarën.

22. Një argument tjetër në mbështetje të qëndrimit tonë ka të bëjë me faktin se Gjykata e Lartë ka në shqyrtim çështjen me objekt kërkim trashëgimie, ku një trashëgimlënëse ka disponuar pasurinë e saj me testament, duke caktuar si trashëgimtar të vetëm *nipin e bashkëshortit të saj*. Trashëgimtarja e vetme ligjore e trashëgimlënëses, duke mos qenë dakord me këtë disponim, e ka kundërshtuar testamentin në gjykatë, si në kundërshtim me nenin 377 të KC-së. Kjo është edhe dispozita ligjore e identifikuar nga Gjykata e Lartë si dispozita e zbatueshme në gjykimin e mosmarrëveshjes civile para saj, e cila ndalon disponimin me testament të pasurisë në favor të një personi të tretë, për sa kohë trashëgimlënësja ka lënë më së paku të paslindur (paditësen). Po kështu, edhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka në shqyrtim një tjetër çështje me objekt konstatimin pjesërisht të pavlefshmërisë absolute të testamentit të një shtetasi, i cili ka caktuar si trashëgimtarë *fëmijën e tij të mitur dhe bashkëjetuesen*, duke identifikuar nenin 377 të KC-së si dispozitën e zbatueshme për zgjidhjen e çështjes, në lidhje me nenin 406 të KC-së, sipas të cilit disponimi në kundërshtim me nenin 377 të KC-së e bën testamentin të pavlefshëm.

23. Si gjyqtarë në pakicë, vlerësojmë se, edhe pse shumica ka vendosur konstatimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 377 të KC-së, për shkak të boshllëkut ligjor, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për kontroll incidental, qasja e mbajtur në vendim nga shumica nuk u jep përgjigje rasteve të parashtruara për gjykim para gjykatave referuese, pra nuk zgjidh çështjet konkrete për shqyrtim para Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

24. Për më tepër, në dispozitivin e vendimit, nga njëra anë, shumica vendos konstatimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 377 të Kodit Civil, për shkak të boshllëkut ligjor, dhe detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për plotësimin e tij brenda një viti nga hyrja në fuqi e vendimit, ndërsa, nga ana tjetër, shprehet se vendimi i saj hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare Një vendimmarrje e tillë e shumicës krijon pasiguri juridike për efektet që vendimmarrja e saj do të ketë si ndaj individëve që duan të disponojnë pasurinë me testament, përmes caktimit të trashëgimtarëve, ashtu edhe për çështjet aktualisht për shqyrtim para juridiksionit të zakonshëm, përfshirë edhe çështjet konkrete për shqyrtim nga gjykatat referuese.

25. Si konkluzion, vlerësojmë se në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së gjykatave referuese duhej të ishte vendosur rrëzimi i saj për të gjitha argumentet e dhëna më lart.

Anëtarë: Elsa Toska, Ilir Toska